



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 551 Akti

Nr. 671 Vendimi  
Tiranë, më 14.6.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Lulzim Hamitaj</b>	Kryesues
<b>Genta Tafa (Bungo)</b>	Relatore
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 12.6.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), kati I, salla ovale, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Ylli Bashaj**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Subjekti i rivlerësimit, z. Ylli Bashaj, aktualisht me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, është subjekt rivlerësimi, që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), në datën 15.6.2020, zhvilloi procedurën e shpërndarjes me short të çështjeve në trupa gjykuese, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Ylli Bashaj, do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Lulzim Hamitaj dhe Valbona Sanxhaktari. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionerja Genta Tafa (Bungo).
4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 17.6.2020 u caktua me mirëkuptim kryesues i trupit gjykues z. Lulzim Hamitaj, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.
5. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, z. Ylli Bashaj, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.
6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.
8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.
9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK); dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP). Këto raporte janë administruar nga relatorja me fillimin e hetimit administrativ.

**10.** Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dërgoi raportin<sup>1</sup> e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Ylli Bashaj. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

**11.** Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja ka dërguar raportin<sup>2</sup> e saj për subjektin e rivlerësimit, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Ylli Bashaj.

**12.** Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, një raport<sup>3</sup> të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

**13.** Në vijim, relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; vlerësimi i aftësive profesionale.

**14.** Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 27.4.2023 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur prova dhe shpjegime, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

**15.** Subjekti i rivlerësimit, në datën 3.5.2023, u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 9.5.2023, ndërsa më 17.5.2023 ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në përgjigje të rezultateve të hetimit.

**16.** Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore<sup>4</sup>.

<sup>1</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.5.2018.

<sup>2</sup> Raporti nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*, datë 6.1.2021, të KDZH-së.

<sup>3</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.4.2022.

<sup>4</sup> Vendimi i ndërmjetëm nr. 3, datë 31.5.2023.

## II. SEANCA DËGJIMORE

17. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike me njoftimin e bërë elektronikisht me *email*, në datën 31.5.2023.

18. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 12.6.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), kati I, salla ovale, Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs.

19. Subjekti i rivlerësimit, z. Ylli Bashaj, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

## III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

20. Z. Ylli Bashaj ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur në kohë, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë të gjithë procedurës së hetimit administrativ, por përgjigjet e tij në një rast nuk kanë qenë në përputhje me kërkesat e Komisionit.

## IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

21. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

21.1 Referuar vendimit nr. 2/2017<sup>5</sup> të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr.

---

<sup>5</sup> “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore, që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë Komisionit nga AKSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga KLP-ja; (ë) denoncimet e publikut; (f) gjetjet dhe opinionin e paraqitur me shkrim nga vëzhguesi ndërkombëtar; (g) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

**23.** Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklaratimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si dhe në burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

**23.1** Subjekti ka filluar detyrën në datën 5.3.1992, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

**23.2** Në deklaratën *Vetting* (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 23.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:

**24. Apartament<sup>6</sup> me sipërfaqe 93.09 m<sup>2</sup>, blerë me kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 17.12.2000, për vlerën 28,000 USD.** Vlera e asetit: 28,000 USD, e shlyer tërësisht.

**Burimi sipas deklaratës *Vetting*:** 10,000 USD kursime nga të ardhurat, 10,000 USD marrë në formën e borxhit nga të afërmit dhe miqtë dhe 10,000 USD marrë kredi nga Banka Italo-Shqiptare, sipas kontratës nr. \*\* rep., nr. \*\* kol., datë 1.2.2001.

### **Hetimi<sup>7</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**25.** Me kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 27.12.2000, subjekti i rivlerësimit ka blerë nga shoqëria "S.M" sh.p.k. apartament me sip. 93.09 m<sup>2</sup>, regjistruar në regjistrin hipotekor nr. \*\*\*, datë 17.10.2000, ndodhur në rrugën "H.D", Tiranë, me çmim shitblerjeje 28,000 USD. Referuar planimetrisë që i bashkëlidhet kontratës së shitjes, rezulton se sipërfaqja e brendshme totale e apartamentit është 87.09 m<sup>2</sup>, ndërsa sipërfaqet e përbashkëta janë 6 m<sup>2</sup>.

**26.** Në përmbajtje të kontratës së shitblerjes palët deklarojnë se shuma 28,000 USD është likuiduar jashtë zyrës noteriale, pa pretendime nga palët, si dhe në gjendjen dhe në kushtet që ajo ndodhet. Subjekti i rivlerësimit është pajisur me certifikatë pronësie datë 7.12.2018<sup>8</sup> për këtë pasuri të regjistruar me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, me sipërfaqe totale 87.09 m<sup>2</sup>.

### **Në lidhje me çmimin e kësaj pasurie**

**27.** Subjekti i rivlerësimit, në deklarinimin vjetor të vitit 2003, si dhe në deklaratën *Vetting*, ka deklaruar se çmimi i kësaj pasurie është 28,000 USD.

<sup>6</sup> Subjekti ka depozituar: (i) certifikatë për vërtetim pronësie; (ii) kontratë shitjeje e pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 27.12.2000; (iii) kontratë financimi nr. \*\* rep., nr. \*\* kol., datë 1.2.2001.

<sup>7</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 10.12.2020, drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 10.12.2020, ASHK Tirana Veri; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 23.11.2022, drejtuar shoqërisë "S.M" sh.p.k.; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\* prot., datë 9.12.2022, e shoqërisë "S.M" sh.p.k.; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.09.2019, drejtuar UKT sh.a.; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 28.9.2020, e UKT-së; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.9.2019, drejtuar FSHU sh.a.; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 28.9.2020 FSHU-së.

<sup>8</sup> Sipas dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti pranë ILDKPKI-së, rezulton se fillimisht subjekti është pajisur me certifikatë pronësie datë 27.12.2016, e cila përmban të dhëna jo të sakta të atësisë dhe mbiemrit të tij (Ylli M Basha) dhe, më tej, me urdhër të brendshëm është kryer saktësimi i të dhënave dhe lëshimi i certifikatës së saktë të pronësisë, datë 7.12.2018.

**28.** Në përmbajtje të kontratës së shitjes nr. \*\*\*, datë 27.12.2000, palët deklarojnë se çmimi total prej 28,000 USD është likuiduar jashtë zyrës noteriale, pa pretendime nga palët, si dhe në gjendjen dhe në kushtet që ajo ndodhet.

**29.** Komisioni i ka kërkuar informacion shoqërisë “S.M” sh.p.k. në lidhje me marrëdhënien e shitblerjes me subjektin e rivlerësimit. Kjo shoqëri informon se apartamenti me sip. 93.09 m<sup>2</sup> është blerë nga subjekti kundrejt çmimit 28,000 USD dhe sqaron se nga momenti i kryerjes së pagesave nga blerësi i pasurisë ka kaluar një kohë e gjatë prej 22 vitesh. Në bazë të ligjit “Për Kontabilitetin dhe Tatimet”, dokumentet e kësaj periudhe nuk janë ruajtur. Shoqëria sqaron se kalimi i pronësisë dhe regjistrimi i pronës apartament, me të dhënat sipas kontratës së shitjes datë 27.12.2000, është kryer pas përfundimit të procedurave të regjistrimit, fillimisht në emër të shoqërisë në datën 17.10.2000, e më pas në emër të subjektit përfitues.

**30.** Në përgjigje të pyetësorit datë 31.10.2022, subjekti ka vendosur në dispozicion të Komisionit vërtetimin<sup>9</sup> e shoqërisë “S.M” sh.p.k., në përmbajtje të të cilit shoqëria deklaron se blerësi i apartamentit ka paguar vlerën totale 28,000 USD, nga të cilat 20,000 USD janë paguar nëpërmjet arkës së shoqërisë dhe pjesa tjetër prej 8,000 USD është paguar me bankë.

**31.** Nga hetimi ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshortja e tij janë financuar nga Banka Italo-Shqiptare (aktualisht “Intesa Sanpaolo Bank”) me kredi bankare nr. \*\*\*, datë 1.2.2001, në shumën 8,000 USD, me afat 48-mujor, me qëllim financimi “blerje apartamenti”. Kjo kredi rezulton të jetë disbursuar në llogarinë e subjektit në datën 13.2.2001 dhe po në këtë datë është transferuar në llogarinë bankare të shoqërisë “S.M” sh.p.k., me përshkrimin “S.M për pagesën e kështit të fundit, për blerjen e apartamentit”.

**32.** Në përfundim, duke analizuar përmbajtjen e kontratës së shitjes, nga e cila rezulton se deri në datën e nënshkrimit të saj është likuiduar vlera 28,000 USD dhe dokumentacionin bankar, nga i cili vërtetohet se në datën 13.2.2001 subjekti ka transferuar në llogarinë e shoqërisë shitëse vlerën 8,000 USD, duket se në total subjekti i rivlerësimit ka paguar në favor të shoqërisë “S.M” sh.p.k. vlerën 36,000 USD, e cila përafrohet me çmimet e referencës së Entit Kombëtar të Banesave<sup>10</sup>.

**33.** I pyetur në lidhje me çmimin e apartamentit, në përgjigje të pyetësorit datë 20.1.2023, subjekti ka sqaruar: *“Çmimet e referencës së EKB-së nuk kanë qenë detyruese për subjektet tregtare apo edhe blerësit potencialë të pasurive e, për pasojë, nuk janë aplikuar në shitblerjen e apartamentit, për të cilin subjekti ndërtues kishte përcaktuar si çmim bazë për metër katror atë të vlerës 300 USD/m<sup>2</sup>”*. Ai ka paraqitur si provë kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 27.12.2000, lidhur mes shoqërisë shitëse “S.M” sh.p.k. dhe blerësit H. B. Nga përmbajtja e kësaj kontrate rezulton se blerësi ka përfituar apartamentin me sip. 77 m<sup>2</sup>, për blerjen e të cilit ka paguar shumën 1,500,000 lekë.

**34.** Nga krahasimi i kontratave të shitblerjes rezulton se çmimi i blerjes nga subjekti i rivlerësimit është në vlerën 42,903 lekë/m<sup>2</sup>, ndërsa çmimi i blerjes nga shtetasi H. B. është në vlerën 19,480 lekë/m<sup>2</sup>.

**35.** Në kushtet kur subjekti vuri në dispozicion vetëm një kontratë të ngjashme, Komisioni ka vijuar hetimin, duke i kërkuar ASHK-së kontrata të tjera të ngjashme në të njëjtin ndërtim. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit, ASHK Drejtoria Vendore Tirana Veri<sup>11</sup> ka vënë në

<sup>9</sup> Vërtetim nr. \*\* prot., datë 3.11.2022, lëshuar nga shoqëria “S.M” sh.p.k., në përgjigje të kërkesës së subjektit të rivlerësimit.

<sup>10</sup> Vlera mesatare e shitblerjes së banesave në tregun e lirë për vitin 2001, për qytetin e Tiranës, ka qenë 56,306 lekë/m<sup>2</sup>.

<sup>11</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 16.2.2023 dhe shkresë nr. \*\*\* prot., datë 13.3.2023, drejtuar ASHK-së Drejtoria Vendore Tirana Veri; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 31.3.2023.

dispozicion kontrata të ngjashme të shitblerjes së apartamenteve të gjendura në objektin 8-katësh në zonën e Brrakës, regjistruar me nr. pasurie \*\*\*, ndërtuar nga shoqëria “S.M” sh.p.k.

**36.** Në përfundim të hetimit, në lidhje me çmimin e këtij apartamenti, Komisioni, për të qenë sa më ezaures, i kaloi subjektit barrën e provës, pasi dukej se për blerjen e apartamentit ai ka paguar vlerën 28,000 USD të likuiduar deri në datën e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes, si dhe vlerën 8,000 USD të transferuar nëpërmjet bankës në llogarinë e shoqërisë “S.M” sh.p.k. në datën 13.2.2001. Për rrjedhojë, në analizën financiare të rezultateve të hetimit, çmimi për blerjen e këtij apartamenti u konsiderua 36,000 USD, i paguar në dy këste: një këst u konsiderua i paguar në datën e nënshkrimit të kontratës; një këst në datën e transferimit të shumës 8,000 USD.

**37.** Pas kalimit të barrës së provës<sup>12</sup>, subjekti pretendoi se apartamenti është blerë në vitin 2000 dhe jo në vitin 2001. Paga për këstin e fundit, që ka shërbyer për blerjen e tij, është bërë në shkurt të vitit 2001 dhe në rrugë bankare. Duke mbajtur parasysh vitin e blerjes së tij, nuk ka pasur akte që të pasqyrojnë çmime reference, detyruese për palët e përfshira në një veprim juridik shitblerjeje, të cilave t’u referoheshin. Në asnjë rast, deri në momentin e blerjes së apartamentit, çmimet e referencës së një entit kombëtar nuk janë aplikuar në tregun e pasurive të paluajtshme. Enti Kombëtar i Banesave është një strukturë qeveritare, që funksionon në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Objekt i veprimtarisë së tij është financimi dhe adresimi i nevojave për strehim të popullatës. Çmimet e referencës së kësaj strukture nuk kanë qenë detyruese për subjektet tregtare apo ndërtuese, por edhe për blerësit potencialë të këtyre pasurive. Në tregun e lirë të shitjes së pasurive të paluajtshme, çmimi i shitjes është përcaktuar gjithmonë duke u mbështetur në raportin që vendosej mes njësisë monetare dhe njësisë për metër katror. Ky raport kishte varësi edhe prej raportit kërkesë-ofertë në tregun e pasurive të paluajtshme, e prezenca e tyre në treg ndikonte në marrëveshjen mes palëve për të vendosur çmimin e shitjes në kontratën e shitblerjes. Në rastin e shitblerjes së këtij apartamenti, pronari i subjektit ndërtues e tregtar ka caktuar si çmim bazë për metër katror atë në vlerën 300 USD. Në përfundim të marrëveshjes mbi çmimin e vendosur është bërë edhe pagesa e plotë për njësinë e banimit me dy këste, njëri prej të cilëve në vlerën *cash* dhe tjetri nëpërmjet rrugës bankare. Subjekti pretendon se nga të dhënat e ASHK-së në të njëjtin objekt banimi, ku ndodhet edhe apartamenti i blerë prej tij, blerësit për të njëjtën sipërfaqe banimi kanë paguar 1,100,000 lekë, 1,400,000 lekë dhe 2,000,000 lekë, çmim që është shumë më i vogël se çmimi i pasqyruar në kontratën e shitblerjes së apartamentit të tij. Ai vijon duke argumentuar se çmimi për kosto ndërtimi në vitin 2006 ka qenë 30,000 lekë, që është shumë më e vogël se vlera 300 USD e blerjes së apartamentit, çmim ky i përcaktuar nga shitësi, sipërfaqe ndërtimi për metër katror, që e konvertuar në monedhën vendëse në momentin e veprimit juridik të shitblerjes arrin në shumën 43,500 lekë.

**38.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe pretendimet e tij, vlerëson se ato duhet të merren në konsideratë, duke u vlerësuar në tërësi me (i)deklarimet e subjektit në deklaratat periodike, të cilat, në kuptim të nenit 32/5 të ligjit nr. 84/2016, përbëjnë provë për këtë proces, (ii)veprimet e subjektit për likuidimin e kësaj pasurie, si dhe me (iii)kontratat e ngjashme të lidhura nga shoqëria me blerës të tjerë.

**39.** Më konkretisht rezulton se:

**i.** Subjekti ka qenë konsistent në deklarimet e tij në deklaratat periodike, në deklaratën *Vetting*, por edhe gjatë hetimit administrativ, ku ai ka deklaruar si çmim blerjeje për këtë apartament shumën 28,000 USD. Ai ka kryer të gjitha përpjekjet për të provuar këtë pagesë, duke depozituar edhe vërtetimin nr. \*\*, datë 3.11.2022, të shoqërisë “S.M” sh.p.k., në përmbajtje të

---

<sup>12</sup> Për më shumë, referojuni provave dhe shpjegimeve të paraqitura nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit.

të cilit shoqëria deklaroi se blerësi i apartamentit ka paguar vlerën totale 28,000 USD, nga të cilat 20,000 USD janë paguar nëpërmjet arkës së shoqërisë dhe pjesa tjetër prej 8,000 USD është paguar me bankë. Më tej, kjo shoqëri, në përgjigje të shkresës së dërguar nga Komisioni, ka konfirmuar të njëjtën pagesë, duke deklaruar se apartamenti me sip. 93.09 m<sup>2</sup>, është blerë nga subjekti kundrejt çmimit 28,000 USD dhe sqaron se nga momenti i kryerjes së pagesave nga blerësi i pasurisë ka kaluar një kohë e gjatë prej 22 vitesh. Në bazë të ligjit “Për Kontabilitetin dhe Tatimet”, dokumentet e kësaj periudhe nuk janë ruajtur.

**ii.** Nga hetimi i Komisionit kanë rezultuar kontrata të ngjashme në të njëjtin objekt ku subjekti ka blerë apartamentin, si vijon:

- kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 27.12.2000, me objekt “Shitblerjen e apartamentit me sip. 119 m<sup>2</sup>, për çmimin 1,800,000 lekë ose 15,126 lekë/m<sup>2</sup>”;
- kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 27.12.2000, me objekt “Shitblerjen e apartamentit me sip. 93 m<sup>2</sup>, për çmimin 1,400,000 lekë ose 15,053 lekë/m<sup>2</sup>”;
- kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 21.12.2000, me objekt “Shitblerjen e apartamentit me sip. 93 m<sup>2</sup>, për çmimin 2,000,000 lekë ose 21,500 lekë/m<sup>2</sup>”;
- kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 22.12.2000, me objekt “Shitblerjen e pasurisë dyqan në katin përdhe, me sip. 63.27 m<sup>2</sup>, për çmimin 1,400,000 lekë ose 22,127 lekë/m<sup>2</sup>”;
- kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 26.12.2000, me objekt “Shitblerje tarrace ap. 106 m<sup>2</sup>, sipërfaqe e shfrytëzueshme 134 m<sup>2</sup>, pra sipërfaqe e përgjithshme 240 m<sup>2</sup>, për çmimin 2,000,000 lekë ose 8,333 lekë/m<sup>2</sup>”;
- kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 27.12.2000, me objekt “Shitblerjen e apartamentit me sip. 77 m<sup>2</sup>, për çmimin 1,500,000 lekë ose 19,480 lekë/m<sup>2</sup>”.

**40.** Për sa më sipër, shoqëria ka shitur me një çmim, i cili i përafrohet çmimit të kostos së ndërtimit për qytetin e Tiranës, që për vitin 2000 ka qenë në vlerën 24,870 lekë/m<sup>2</sup>. Ndërkohë, subjekti i rivlerësimit e ka blerë pasurinë e tij në një vlerë më të lartë se çmimi për kosto ndërtimi, por edhe gati dyfish më të lartë se çmimi i blerjes për kontrata të ngjashme në të njëjtën ndërtesë.

**41.** Në lidhje me gjendjen e konfliktit të interesit, Komisioni ka administruar informacion<sup>13</sup> nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pranë së cilës subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën në vitet 1998 – 2002, që përkon me periudhën e nënshkrimit të kontratës së shitjes me shoqërinë “S.M” sh.p.k. dhe likuidimin e çmimit të kësaj kontrate. Në përgjigjen e saj, prokuroria informon se nuk rezultojnë procedime penale të hetuara nga subjekti i rivlerësimit në emër të shoqërisë “S.M” sh.p.k., administratorit të kësaj shoqërie në periudhën e nënshkrimit të kontratës së shitjes, shtetasit G.H, dhe bashkëshortes së tij N.H.

### **Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie**

**42.** Si burim për blerjen e këtij apartamenti në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar:

- 10,000 USD kursime nga të ardhurat;
- 10,000 USD marrë kredi në formën e huas nga të afërmit dhe miqtë;
- 10,000 USD marrë kredi nga Banka Italo-Shqiptare sipas kontratës datë 1.2.2001.

**43.** Në DPV/2003, subjekti i rivlerësimit ka përshkruar burimin e krijimit të pasurisë, si vijon:

- 13,000 USD kursime me bashkëshorten;
- 2,000 USD hua nga shtetasi K.B; 2,000 USD hua nga shtetasi H.B; 1,500 USD hua nga shtetasi E.H; 1,500 USD hua nga shtetasi S.V(vlera totale e huamarrjes rezulton 7,000 USD);

---

<sup>13</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 20.1.2023, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 20.1.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.



- 10,000 USD Banka Italo-Shqiptare sipas kontratës noteriale.

44. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar huamarrje në vlerën totale 7,000 USD nga shtetasit H.B, KB, E.H dhe S.V.

45. I pyetur lidhur me deklaratimet kontradiktore të burimit të krijimit të kësaj pasurie, në përgjigje të pyetësorit datë 31.10.2022, subjekti ka deklaruar se kjo gjë ka ndodhur për shkak të pakujdesisë dhe mungesës së verifikimit përfundimtar të të dhënave të deklaratës *Vetting*.

46. Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit duhet të kishte treguar kujdesin e nevojshëm që të plotësonte saktë deklaratën *Vetting*, sikundër kërkohet nga ligji nr. 84/2016. Kjo pasi deklaratimet e tij në deklaratën *Vetting* në lidhje me burimin e krijimit të apartamentit nuk përputhen me deklaratimet e tij në DPV/2003, pyetësorin standard, si dhe me deklaratimet e dhëna gjatë hetimit administrativ. Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës në lidhje me këtë konstatim.

47. Në parashtrimet e tij, pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka dhënë<sup>14</sup> të njëjtat shpjegime si gjatë hetimit administrativ, duke shtuar se, në kolonën me shifrën 10,000 USD të kredisë së dhënë nga banka, për shlyerjen e kështit të fundit të pagesës së apartamentit, është pasqyruar kjo shifer, kur duhet të ishte vetëm shifra 8,000 USD, e mbledhur edhe me interesat për kredinë e dhënë, që ishin 2,000 USD. Një pasqyrim i tillë i gabuar nuk është përsëritur në deklaratimet e pasqyruara në pyetësorin standard, deklarime të cilat përputhen me të dhënat e pasqyruara në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2003, që është deklaratë e përpiluar për herë të parë, në të cilën rishtazi e njëherazi janë pasqyruar fakte, që kanë ndodhur në një periudhë të afërt me momentin e përpilimit të saj. Veprimet e kryera janë në kuadër të qëndrimit të pakujdesshëm në formulimin dhe pasqyrimin e të dhënave në formularin përkatës.

48. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ, konstaton se duke analizuar në tërësi vlerën e deklaruar të pasurisë së apartamentit, si dhe vlerën e secilit burim, në raport edhe me deklarimin e subjektit në DPV/2003, pretendimi i tij për pasaktësinë në deklarimin e vlerave të burimeve në deklaratën *Vetting* qëndron dhe është një pasaktësi e korrigjuar në vijim përmes deklaratimeve të tij në pyetësorin standard. Në këto kushte, për sa kohë me këtë deklaratim të pasaktë subjekti nuk ka pasur për qëllim të fshehtë pasurinë e tij, si dhe ky deklaratim i pasaktë është korrigjuar prej tij gjatë hetimit administrativ, Komisioni vlerëson se ai nuk mund të përbëjë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit për subjektin e rivlerësimit.

#### **i. Në lidhje me kursimet në shumën 13,000 USD**

49. Komisioni ka kryer analizën financiare lidhur me mundësinë e subjektit për realizimin e kursimeve në vlerën 13,000 USD, duke marrë në konsideratë deklarimin e tij në DPV/2003.

**Tabela nr. 1**

	<b>Periudha 1992 – 1999</b>
<b>Pasuria</b>	<b>1,920,650.00</b>
Apartament në qytetin e Vlorës, me sip. 82 m <sup>2</sup>	0.00
Automjet tip “Opel Cadet”, 21.11.1995	130,680.00
<i>Ndryshim likuiditeti (kursime cash 13,000 USD)</i>	<i>1,789,970.00</i>
<b>Detyrime</b>	<b>0.00</b>
<b>Pasuria neto</b>	<b>1,920,650.00</b>
<b>Të ardhura</b>	<b>2,793,326.00</b>
Të ardhurat e subjektit nga paga	1,708,901.00
Të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga paga	1,084,425.00

<sup>14</sup> Për më shumë, referojuni provave dhe shpjegimeve të paraqitura nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit.

<b>Shpenzime</b>	<b>1,137,997.80</b>
Shpenzime jetike	837,997.80
TIMS	0.00
Shpenzime për marrje apartamenti me qira	300,000.00
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-265,321.80</b>

**50.** Bazuar në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit, në analizën financiare për periudhën 1992 – 1999 janë përfshirë:

- a. të ardhurat e dokumentuara të subjektit nga paga, në vlerën 1,708,901 lekë;
  - b. të ardhurat e dokumentuara të bashkëshortes së subjektit nga paga, në vlerën 1,084,425 lekë;
  - c. shpenzimet jetike të përlllogaritura në masën 30% deri në vitin 1999<sup>15</sup>;
  - d. shpenzimet për marrjen me qira të ambientit të banimit, të deklaruara nga subjekti në pyetëtorin standard për periudhën prill 1998 – mars 2000.
- Lidhur me të ardhurat e subjektit për vitet 1992, 1994, 1995, për të cilat nuk disponohet dokumentacion provues, të dhënat mbi përfitimin financiar nga paga në analizën financiare për subjektin janë përfshirë mbi bazën e VKM-së Nr. 393, datë 3.9.1992, “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore” dhe ligjit nr. 7800, datë 2.3.1994, “Për pagat e gjyqtarëve, ndihmës gjyqtarëve efektivë dhe prokurorëve”<sup>16</sup>;
  - Në analizë financiare nuk janë përfshirë të ardhurat e bashkëshortes së subjektit të përfituara si Oficere e Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për vitin 1992, pasi nuk disponohet dokumentacion provues<sup>17</sup>. Për periudhën 1994 – 1995 është marrë si pagë referuese paga e vitit 1993 në vlerën 57,902 lekë, derisa subjekti të provojë një shumë tjetër.

**51.** Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e gjendjes *cash* prej 13,000 USD, në shumën 265,321.80 lekë.

**52.** Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka kërkuar<sup>18</sup> saktësimin e të ardhurave të përfituara prej tij dhe bashkëshortes në vitet 1994, 1995 e 1998 dhe, në mbështetje të këtij pretendimi, paraqiti dokumentacionin si vijon:

- a. vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 5.5.2023, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, lidhur me të ardhurat e V. B në vitet 1998, 1999 dhe 2000;
- b. vërtetim datë 5.5.2023, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lidhur me të ardhurat e Y. Bashaj për periudhën mars 1998 – 31 dhjetor 2000;
- c. vërtetim nr. \*\*\*prot., datë 8.5.2023, i Prokurorisë së Përgjithshme, lidhur me punësimin e Y. Bashaj në këtë institucion dhe pagat referuese për vitet 1992 – 1998;
- d. vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 8.5.2023, i Prokurorisë së Përgjithshme, lidhur me punësimin e V. B në këtë institucion dhe pagat referuese për vitet 1992 – 1998.

**53.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe dokumentacionin e depozituar prej tij, i cili kishte të dhëna që nuk ishin administruar gjatë hetimit, vlerësoi të pranojë në cilësinë e

<sup>15</sup> Vendim nr. \*\* datë 15.6.2021, i Kolegjit, subjekti I. B.

<sup>16</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 31.7.2019, e Komisionit drejtuar KLGJ-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 2.9.2019, e KLGJ-së, ku citohet baza ligjore për pagat e gjyqtarëve për periudhën 1992 – 2000 dhe legjislacioni i cituar përfshin edhe informacion lidhur me pagat e prokurorëve në këto vite.

<sup>17</sup> Në dosjen e ILDKPKI-së subjekti ka paraqitur vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 21.10.2016, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, përmes të cilit ky institucion konfirmon mungesën e dokumentacionit për pagat në vitet 1992, 1994 dhe 1995.

<sup>18</sup> Për më shumë, referojuni provave dhe shpjegimeve të paraqitura nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit.

provës dokumentacionin e depozituar nga subjekti. Për rrjedhojë, për sa kohë ky dokumentacionin përmbante të dhëna të reja, ato u përfshinë në analizë financiare, paraqitur në tabelën si më poshtë:

**Tabela nr. 2**

	<b>Periudha 1992 – 1999</b>
<b>Pasuria</b>	<b>1,920,650.00</b>
Automjet tip “Opel Cadet”, 21.11.1995	130,680.00
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>1,789,970.00</i>
<b>Detyrime</b>	<b>0.00</b>
<b>Pasuria neto</b>	<b>1,920,650.00</b>
<b>Të ardhura</b>	<b>3,045,898.09</b>
Të ardhurat e subjektit nga paga	1,751,155.55
Të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga paga	1,294,742.55
<b>Shpenzime</b>	<b>1,213,769.43</b>
Shpenzime jetike	913,769.43
TIMS	0.00
Shpenzime për marrje apartamenti me qira	300,000.00
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-88,521.34</b>

**54.** Nga analiza financiare rezulton se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e gjendjes *cash* prej 13,000 USD, në shumën 88,521.34 lekë.

## **ii. Në lidhje me huamarrjet**

**55.** Në DPV/2003, subjekti ka deklaruar: “*Hua 2,000 USD nga K.B; hua 2,000 USD nga H.B; hua 1,500 USD nga E.H; hua 1,500 USD nga S.V. Vlera totale e huamarrjes rezulton të jetë 7,000 USD*”.

### **a. Hua e marrë nga shtetasi K.B (vëllai i subjektit), në vlerën 2,000 USD**

**56.** Në përgjigje të pyetësorit datë 31.10.2022, subjekti ka sqaruar se të ardhurat e shtetasit K. B për dhënien e huas në favor të tij kanë si burim pagat e tij dhe të bashkëshortes.

Për të provuar mundësinë financiare të këtij huadhënësi, ai ka depozituar:

- Deklaratë noteriale datë 6.11.2022, të shtetasit K.B, i cili deklaron se *në vitin 2000 ka kontribuar për krijimin e fondit të mjaftueshëm për blerjen e apartamentit nga vëllai i tij, duke i dhënë hua shumën 2,000 USD, të cilën e konsideron si kursime familjare. Këtë vlerë detyrimi vëllai Ylli Bashaj ia ka kthyer me këste, herë pas here deri në vitin 2007. Kjo marrëdhënie nuk është formalizuar me ndonjë dokument shkresor, për shkak të marrëdhënies së posaçme.*

- Vërtetime (të padatuara) të lëshuara nga DRSSH-ja lidhur me të ardhurat e realizuara nga shtetasit K dhe F.B. Nga përmbajtja e këtyre vërtetimeve rezulton se për periudhën 1998 – 2000 (dhënien e huas) vëllai i subjektit së bashku me bashkëshorten e tij kanë përfituar të ardhurat në shumën totale 1,404,524.00 lekë.

**57.** Nga analiza financiare<sup>19</sup> e kryer nga Komisioni rezultoi se vëllai i subjektit dhe bashkëshortja e tij kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për dhënien e huas në vlerën 2,000 USD, në favor të subjektit të rivlerësimit.

<sup>19</sup> Shih tabelë nr.2 të rezultateve të hetimit.

## **b. Hua e marrë nga shtetasi H.B, në vlerën 2,000 USD**

**58.** Në përgjigje të pyetësorit datë 31.10.2022, subjekti ka paraqitur deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 1.11.2022, të shtetasit H.B, i cili deklaron se në vitin 2000 (kohën e saktë nuk e kujton) i ka dhënë hua djalit të xhaxhait të tij Ylli Bashaj shumën 2,000 USD, për blerjen e apartamentit. Ai deklaron se kthimi i kësaj shume është bërë i plotë në vitin 2004, por nuk kujton kohën e saktë të kthimit të tyre. Në lidhje me burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për dhënien e kësaj huaje huadhënësi deklaron se ka pasur të ardhura të mjaftueshme, pasi ka ushtruar aktivitet privat në fushën e hotelierisë.

Subjekti i rivlerësimit ka depozituar ekstraktin e QKB-së të subjektit tregtar “H.B”, person fizik, për ushtrimin e aktivitetit “motel”, me datë regjistrimi 3.4.2012. Duke konsideruar që huamarrja nga ky shtetas daton në vitin 2000, ky dokument/ekstrakt nuk mund të përbëjë provë për të vërtetuar të ardhurat e huadhënësit, të cilat kanë shërbyer si burim për dhënien e huas.

**59.** Komisioni ka hetuar<sup>20</sup> në lidhje me aftësinë financiare të shtetasit H.B për dhënien e huas. Nga hetimi i kryer, si dhe nga dokumentacioni i paraqitur gjatë hetimit, subjekti i rivlerësimit nuk evidentoi të ardhura të shtetasit H.B, të cilat të mund të kenë shërbyer si burim për dhënien e huas në vlerën 2,000 USD në vitin 2000.

**60.** Në kushtet kur subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion provues lidhur me të ardhurat e ligjshme të huadhënësit H.B, të cilat kanë shërbyer si burim për dhënien e huas në vlerën 2,000 USD, Komisioni nuk e ka konsideruar huamarrjen nga ky shtetas si burim për blerjen e pasurisë apartament, duke i kaluar subjektit barrën e provës për të depozituar dokumentacion provues lidhur me të ardhurat e ligjshme të këtij huadhënësi.

**61.** Pas kalimit të barrës së provës<sup>21</sup>, subjekti pretendoi se huadhënësi ka pasur të ardhura të mjaftueshme, pasi ka ushtruar aktivitet privat në fushën e hotelierisë, aktivitet që është ushtruar për një kohë të gjatë në informalitet të plotë. Për rrjedhojë, ai, si të gjithë personat e përfshirë në aktivitete të tilla, nuk ka qenë pjesë e regjistrimit të aktivitetit të të ardhurave të tyre në institucionet shtetërore, situatë që fatkeqësisht ka vazhduar për një kohë të gjatë në vendin tonë. Subjekti deklaron se kur dikush ka nevojë për të siguruar hua, dhe e tillë ka qenë edhe situata e tij, për ta siguruar atë drejtohen tek personat që kanë të ardhura të mjaftueshme për të qenë huadhënësi. Mundësia e tij financiare për dhënien e kësaj huaje ka qenë e mjaftueshme, madje ai ka pasur edhe mundësi kursimi, përpos të ardhurave që ka siguruar në tregun informal. Për disa vite ai ka qenë edhe klient i Bankës së Kursimeve dhe për të vërtetuar faktet e cituara më sipër ka vënë në dispozicion të Komisionit edhe dokumentet përkatëse.

Subjekti ka depozituar vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 11.5.2023, lëshuar nga “Raiffeisen Bank”, sipas të cilit shtetasi H.B ka pasur depozita në këtë bankë.

**62.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ai nuk ka provuar me dokumentacion provues burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit H.B, për rrjedhojë huaja në shumën 2,000 USD nuk do të përfshihet në analizën financiare për blerjen e këtij apartamenti.

## **c. Hua e marrë nga shtetasi E.H, në vlerën 1,500 USD**

**63.** Në lidhje me këtë huamarrje, në përgjigje të pyetësorit standard subjekti ka deklaruar: *“Prej mikut dhe kolegut tim E.H, po për interes të financimit për blerjen e apartamentit ku aktualisht*

<sup>20</sup> Shkresë nr. \*\* prot., datë 16.2.2023, drejtuar ISSH-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 23.2.2023, e ISSH-së; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2023, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 6.3.2023, e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 16.2.2023, drejtuar DPSHTRR-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 9.3.2023, e DPSHTRR-së.

<sup>21</sup> Për më shumë, referojuni provave dhe shpjegimeve të paraqitura nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit.

*banoj, është marrë një borxh prej 1,500 USD, i cili është shlyer tërësisht pas vitit 2004. Aftësia paguese e tij ka qenë e mjaftueshme për dhënien e borxhit, për faktin e thjeshtë se bashkëshortja e tij ka kryer që prej vitit 1993 detyrën e noteres në qytetin e Vlorës, ndërsa ai vetë detyrën e prokurorit”.*

**64.** Subjekti i rivlerësimit ka depozituar ekstraktin e QKB-së të subjektit tregtar “I.B”, person fizik, për ushtrimin e aktivitetit “Noteri”, me datë regjistrimi 31.3.2003. Ai ka depozituar gjithashtu deklaratë të thjeshtë, datë 6.11.2022, të shtetasve E.H dhe I.B, të cilët deklarojnë se në fillim të vitit 2000 i kanë dhënë hua pa interes në shumën 1,500 USD, shtetasit Ylli Bashaj, për blerjen e një apartamenti. Ata deklarojnë se duke filluar nga viti 2004 dhe në vazhdim, shuma e mësipërme u është kthyer me disa këste të herëpashershme vijuese, në formë *cash*. Kjo marrëdhënie nuk është formalizuar me ndonjë dokument shkresor.

**65.** Komisioni ka konstatuar se huadhënësi E.H ka qenë gjithashtu subjekt rivlerësimi, procesi i të cilit ka përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.1.2021. Referuar analizës financiare të kryer nga Komisioni në tabelën nr. \*, faqja \*\*e këtij vendimi, rezulton se në periudhën 1.1.1993 – dhjetor 2000 shtetasi E.H dhe bashkëshortja e tij kanë pasur mundësi kursimi në vlerën 4,002,923 lekë. Për pasojë, duket se huadhënësi E.H ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për huadhënien në vlerën 1,500 USD, në favor të subjektit të rivlerësimit, në fillim të vitit 2000.

#### **ç. Hua e marrë nga shtetasi S.V, në vlerën 1,500 USD**

**66.** Në lidhje me këtë huamarrje, në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar: *“S.V, lidhje e imja shoqërore, i cili në vazhdimësi ka kryer detyrën e avokatit, më ka financuar me një borxh prej 1,500 USD, të ardhura të siguruara nga puna e tij, të cilat pjesë-pjesë janë shlyer deri në vitin 2007. Nuk disponoj asnjë dokument specifik që vërteton marrjen apo shlyerjen e borxhit”.*

**67.** Në përgjigje të pyetësorit datë 31.10.2022, subjekti ka bashkëlidhur:

- Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 8.11.2022, të shtetasit S.V, i cili deklaroi se në vitin 2000 (kohën e saktë nuk e kujton) i ka dhënë hua shtetasit Ylli Bashaj shumën 1,500 USD, për blerjen e një apartamenti. Ai deklaroi se kjo shumë është shlyer tërësisht deri në vitin 2007 dhe nuk është mbajtur ndonjë akt i veçantë për dhënien apo kthimin e huas. Për sa i përket burimit të të ardhurave, huadhënësi shprehet se ka pasur të ardhura të mjaftueshme, pasi ka ushtruar aktivitet privat në fushën e avokatisë.
- Ekstrakt i QKB-së i subjektit tregtar “S.V, person fizik, për ushtrimin e aktivitetit “Avokati”, me datë regjistrimi 1.1.2003, si dhe NIPT i lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për këtë subjekt, ku evidentohet regjistrimi i subjektit në gjykatë, në datën 3.12.1998.

**68.** Komisioni ka hetuar<sup>22</sup> në lidhje me aftësinë financiare të shtetasit S.V për dhënien e huas. Nga hetimi i kryer, si dhe nga dokumentacioni i paraqitur gjatë hetimit, subjekti i rivlerësimit nuk evidentoi të ardhura të shtetasit S.V, të cilat të mund të kenë shërbyer si burim për dhënien e huas në vlerën 1,500 USD.

**69.** Në kushtet kur subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion provues lidhur me të ardhurat e ligjshme të huadhënësit S.V, të cilat kanë shërbyer si burim për dhënien e huas në vlerën 1,500 USD, Komisioni nuk e ka konsideruar huamarrjen nga ky shtetas si burim për blerjen e pasurisë

---

<sup>22</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 16.2.2023, drejtuar ISSH-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 23.2.2023, e ISSH-së; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2023, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 6.3.2023, e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 16.2.2023, drejtuar DPSHTRR-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 9.3.2023, e DPSHTRR-së.

apartament, duke i kaluar subjektit barrën e provës për të depozituar dokumentacion provues lidhur me të ardhurat e ligjshme të këtij huadhënësi.

**70.** Pas kalimit të barrës së provës<sup>23</sup>, subjekti pretendoi se në periudhën e huadhënies, shtetasi S.V ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për dhënien e huas, të siguruar nga aktiviteti i tij privat si “Avokati”.

Subjekti i ka bashkëlidhur shpjegimeve të tij:

- deklaratë jonoteriale datë 9.5.2023, e deklaruesit S.V, në përmbajtje të së cilës deklaroi huadhënien e vlerës 1,500 USD në favor të subjektit, me burim nga aktiviteti i tij “Avokati”, përmes të cilit në vitin 2000 ka përfiturar të ardhura mbi vlerën 2 milionë lekë;
- fletënjoftim tatimi nga Dega e Tatim-Taksave pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, ku evidentohet tatimi i paguar nga tatimpaguesi S.V për vitin 2000, në vlerën totale 80,000 lekë, bazuar në xhiron e deklaruar prej tij “xhiro deri në 2 milionë lekë”.

**71.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, konstaton se në dokumentin “Fletënjoftim tatimi” pasqyrohen detyrimet e paguara prej shtetasit S.V për dy gjashtëmujorë, për xhiron vjetore të deklaruar prej tij në vitin 2000, deri në vlerën 2 milionë lekë. Gjithashtu, bazuar në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit, konkretisht kopjen e NIPT-it të lëshuar nga Drejtoria e Tatim-Taksave, rezulton se me vendimin gjyqësor nr. \*\*\*, datë 3.12.1998, shtetasi S.V është regjistruar në gjykatë për ushtrimin e aktivitetit “Avokati”.

**72.** Për rrjedhojë, Komisioni, duke marrë në konsideratë faktet dhe provat e analizuar më sipër, konkludon se disponon të dhëna të mjaftueshme që provojnë të ardhurat e ligjshme të shtetasit S.V, që kanë shërbyer si burim për dhënien e huas prej 1,500 USD në favor të subjektit të rivlerësimit.

**73.** Komisioni, duke vlerësuar faktin se subjekti mundi të provojë se huadhënësi S.V ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për dhënien e huas, vendosi ta përfshijë këtë hua në analizën financiare për blerjen e pasurisë apartament.

**74.** Në lidhje me kryerjen e analizës së huadhënësve, Komisioni është bazuar në orientimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit<sup>24</sup>, si dhe në vendimin nr. 2/2023, ku ky i fundit shprehet: *“Kolegji vlerësoi se për personin tjetër të lidhur analiza financiare duhet shtrirë në drejtim të verifikimit të mundësisë për të krijuar me të ardhura të ligjshme pasurinë, e cila është objekt i marrëdhënies së dhurimit, në këtë rast shumat respektive të përshkruara më lart. Pjesë e kësaj analize do të jenë edhe shpenzimet e kryera prej tij për të përballuar kostot e jetesës, si një e dhënë bazike e përdorur tashmë për analizimin e mundësive financiare të personave të tjerë të lidhur, sipas jurisprudencës së Kolegjit. Ky vlerësim konsiderohet se përmbush kriteret e një vlerësimi të arsyeshëm e proporcional lidhur me mundësitë e personave të tjerë të lidhur, duke krijuar një panoramë të mjaftueshme për marrjen e një vendimi lidhur me burimet e ligjshme të krijimit të pasurive të dhëna hua apo dhuruar sipas rastit.”*

### **Në lidhje me shlyerjen e huave**

**75.** Gjatë hetimit të kryer për këtë pasuri, Komisioni ka evidentuar se në deklaratimet vjetore të subjektit pranë ILDKPKI-së, nuk është deklaruar kthimi i huave ndaj huadhënësve. Në lidhje me këtë konstatim, në përgjigje të pyetësorit datë 31.10.2022, subjekti ka deklaruar: *“...lidhur me këtë fakt, deklaroj se një gjë e tillë nuk është bërë me shlyerje të menjëhershme të secilës shumë të huas e, për më tepër, nuk ka ndodhur në një moment të caktuar. Në pjesën më të*

<sup>23</sup> Për më shumë, referojuni provave dhe shpjegimeve të paraqitura nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit.

<sup>24</sup> Vendim nr. 20/2019 dhe nr. 15/2019.

*madhe të rasteve, shumat e huas nuk janë shlyer tërësisht, por pjesë-pjesë dhe shuma për secilën hua ka qenë nën vlerën 300,000 lekë”.*

**76.** Në përgjigje të pyetësorit standard, në lidhje me kthimin e huave, subjekti ka deklaruar:

- Huaja e marrë nga shtetasi K.B është shlyer pjesë-pjesë dhe tërësisht deri në vitin 2007.
- Huaja e marrë nga shtetasi H.B është shlyer tërësisht në fund të vitit 2004.
- Huaja e marrë nga shtetasi E.H është shlyer tërësisht pas vitit 2004.
- Huaja e marrë nga shtetasi S.V është shlyer pjesë-pjesë deri në vitin 2007.

**77.** Përmes pyetësorit datë 31.10.2022, Komisioni i ka kërkuar subjektit të saktësojë periudhat dhe vlerën përkatëse të shlyerjes së secilës hua. Në përgjigje të këtij pyetësori, subjekti ka deklaruar: *“Shlyerja ndaj huadhënësve nuk është bërë në mënyrë të menjëhershme e, për më tepër, nuk ka ndodhur në një moment të caktuar. Në pjesën më të madhe të rasteve shumat e huas nuk janë shlyer tërësisht, por pjesë-pjesë dhe shumat për secilën hua kanë qenë nën shumën 300,000 lekë. Periudha që ka shërbyer edhe si kohë për shlyerjen e shumave të huave përkon me periudhën e transferimit tim në Prokurorinë e Përgjithshme, transferim që është realizuar në muajin prill të vitit 2002.”*

**78.** Në lidhje me pretendimin e subjektit mbi mosdeklarimin e shlyerjes së huave apo detyrimit financiar të pashlyer ndaj personave të tretë, Komisioni konstaton se qëndrimi i subjektit nuk është në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”. Në shkronjën “dh” të nenit 4 të këtij ligji përcaktohet se objekt deklarimi nga subjektet e ligjit ndër të tjera, janë “...detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj”, pa përcaktuar kufirin e vlerës minimale të detyrimit.

**79.** Për sa më sipër, Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratat vjetore pranë ILDKPKI-së shlyerjet e detyrimeve financiare ndaj huadhënësve, duke i kërkuar atij shpjegime bindëse në lidhje me këtë konstatim.

**80.** Në parashtrimet e tij, subjekti sqaroi sërish se shlyerja e huave nuk është pasqyruar në deklaratat periodike vjetore të pasurisë, pasi ajo nuk është bërë në mënyrë të menjëhershme, por pjesore. Ai shpjegoi gjithashtu se legjislacioni për deklarimin e pasurive nuk është parë me kujdes prej tij.

**81.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, çmon se ai duhet të kishte treguar kujdesin e nevojshëm për deklarimin e detyrimeve financiare, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”. Në kushtet kur këto pasaktësi rezultojnë në deklaratat periodike, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit<sup>25</sup>, ato nuk mund të shërbejnë si indikatorë për procesin e rivlerësimit të subjektit.

**82.** Komisioni ka përfshirë në analizë financiare kthimin pjesor të huas ndaj shtetasit K.B në periudhën prill 2002 – 2007 dhe kthimin pjesor të huas ndaj shtetasit E.H në periudhën 2004 – 2007. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni ka rezultuar se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për shlyerjen e huave ndaj huadhënësve K.B dhe E.H.

**83.** Në vijim, pas kalimit të barrës së provës dhe pranimit të prapësimeve të subjektit në lidhje me huamarrjen nga shtetasi S.V, Komisioni vendosi të përfshijë në analizë financiare kthimin pjesor të huas të marrë nga ky shtetas. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni për shlyerjen e kësaj huaje në vitet 2001 – 2006, rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për shlyerjen e saj.

<sup>25</sup> Vendimet nr. 9/2020 (JR), datë 26.6.2020, nr. 16/2020 (JR), datë 13.7.2020 dhe nr. 31/2020 (JR), datë 18.11.2020, të Kolegjit.

### iii. Në lidhje me kredinë bankare datë 1.2.2001, në BIA Bank

**84.** Nga hetimi<sup>26</sup> ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshortja e tij janë financuar nga Banka Italo-Shqiptare (aktualisht “Intesa Sanpaolo Bank”) me kredi bankare<sup>27</sup> nr. \*\*, datë 1.2.2001, në shumën 8,000 USD, me afat 48-mujor, me qëllim financimi “blerje apartamenti”.

**85.** Komisioni ka mbajtur korrespondencë me bankën kredidhënëse “Intesa Sanpaolo Bank”, duke i kërkuar këtij institucioni bankar dosjen e plotë të kredisë së akorduar në favor të subjektit. Në përgjigjen e saj, banka informon se nga kërkimet e kryera në degë dhe në arkiv nuk është bërë e mundur të gjendet dokumentacioni i kërkuar, pasi është shumë i vjetër në kohë.

**86.** Nga shqyrtimi i llogarisë bankare të subjektit dhe bashkëshortes së tij në BIA Bank, rezulton se kredia është disbursuar në llogarinë e tyre dyemërore në datën 13.2.2001 dhe është transferuar nëpërmjet bankës në llogarinë bankare të shoqërisë “S.M” sh.p.k., me përshkrimin “S.M për pagesën e këstit të fundit, për blerjen e apartamentit”.

**87.** Në lidhje me këtë kredi, Komisioni konstaton se në kontratën e shitblerjes së lidhur mes subjektit dhe shoqërisë “S.M” sh.p.k., në datën 27.12.2000, përcaktohet se pagesa e çmimit 28,000 USD është likuiduar jashtë zyrës noteriale. Kredia bankare në vlerën 8,000 USD është disbursuar dhe transferuar nëpërmjet bankës në llogarinë e shoqërisë shitëse në datën 13.2.2001, më shumë se një muaj nga lidhja e kontratës së shitblerjes datë 27.12.2000. Për rrjedhojë, duket se kjo kredi nuk mund të ketë shërbyer si burim për pagesën e shumës 28,000 USD, por ajo duket se është një pagesë shtesë në favor të shoqërisë “S.M” sh.p.k. Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës në lidhje me këtë konstatim.

**88.** Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka pretenduar se<sup>28</sup>, *për sa i përket prezencës së fakteve juridike të pasqyruar në aktet përkatëse, që janë bërë edhe pjesë e fashikullit të hetimit administrativ, deklaron se është përpiluar e nënshkruar nga palët e përfshira në veprimin juridik për shitblerjen e një pasurie të paluajtshme dhe në këtë akt është përcaktuar çmimi i shitjes, akt i cili është përpiluar në formën e parashikuar nga ligji dhe që nuk ka pasur ndryshime asnjëherë në vlerën e tij. Njëherazi, ky akt, që është nënshkruar nga palët e përfshira në marrëdhënien juridike të shitblerjes së apartamentit, tregon se vlera e pasurisë së apartamentit të shitur është 28,000 USD. Ka një dokument tjetër shkresor, një vërtetim të dhënë nga shoqëria ndërtuese “S.M” sh.p.k., në të cilin thuhet se blerësi i apartamentit ka paguar në favor të shoqërisë vlerën totale 28,000 USD, nga të cilat 20,000 USD janë paguar në arkën e shoqërisë dhe pjesa tjetër prej 8,000 USD është paguar me bankë. Ka një kredi bankare, e cila përsëri është përfituar sipas ligjit dhe është legalizuar në formën e parashikuar nga ligji, në vlerën 8,000 USD, kredi e financuar nga Banka Italo-Shqiptare, cila rezulton të jetë disbursuar në llogarinë e subjektit në datën 13.2.2001 dhe, së fundmi, ka edhe një akt të shkruar që është deklarata periodike vjetore e vitit 2003, pra 20 vite me parë, që nuk ndryshon në të dhënat e pasqyruara, e që njëherazi pasqyron edhe mënyrën e pagesave të kryera në dy këste, burimin e tyre, si dhe mënyrën e shlyerjes së detyrimeve. Të gjithë blerësit e pasurive, në aktet e shitblerjes, në të njëjtin objekt banimi, kanë pasqyruar çmime jashtëzakonisht të ulëta për blerjen e pasurive apartament, ndërsa pasuria e blerë nga ana e tij shkon në një shifër pothuajse tri herë më të lartë... Subjekti vijon argumentin e tij, duke deklaruar: “...me një këst prej 8,000 USD, të paguara përsëri, mund të kisha blerë një apartament tjetër, pasi kjo shumë e konvertuar në lekë arrin shumën e 1,100,000 lekëve”.*

<sup>26</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.9.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 5.10.2020, e “Intesa Sanpaolo Bank”; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 16.2.2023, drejtuar “Intesa Sanpaolo Bank”; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 9.3.2023, e “Intesa Sanpaolo Bank”.

<sup>27</sup> Kjo kredi është garantuar përmes hipotekës së vendosur mbi pasurinë nr. \*\*\*, ndodhur në zonën kadastrale \*\*\* Tiranë, regjistruar në pronësi të shtetasit L.K, babai i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit.

<sup>28</sup> Për më shumë, referojuni provave dhe shpjegimeve të paraqitura nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit.



89. Në përfundim të hetimit, Komisioni ka kryer analizën financiare<sup>29</sup> të subjektit, duke konsideruar pagesën e apartamentit në vlerën 36,000 USD, të ndarë në dy këste: kësti i parë prej 28,000 USD paguar në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes; kësti i dytë prej 8,000 USD paguar me kredinë bankare.

**Tabela nr. 3**

	<b>Periudha 1992 – 2000</b>	<b>13.2.2001</b>
<b>Pasuria</b>	<b>4,124,600.00</b>	<b>0.00</b>
Apartament në qytetin e Tiranës, 93 m <sup>3</sup>	3,993,920.00	1,092,400.00
Automjet tip “Opel Cadet”, 21.11.1995	130,680.00	
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>0.00</i>	<i>0.00</i>
<b>Detyrime</b>	<b>499,240.00</b>	<b>1,092,400.00</b>
Kredi në BIA, 13.2.2001, shuma 8,000 USD	0.00	1,092,400.00
Hua K.B, 2,000 USD	285,280.00	
Hua E.H, 1,500 USD	213,960.00	
Hua H.B	0	
Hua S.V	0	
<b>Pasuria neto</b>	<b>3,625,360.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Të ardhura</b>	<b>3,575,257.00</b>	<b>147,917.33</b>
Të ardhurat e subjektit nga paga	2,128,797.00	83,144.33
Të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga paga	1,446,460.00	64,773.00
<b>Shpenzime</b>	<b>1,614,997.80</b>	<b>72,000.00</b>
Shpenzime jetike	1,269,997.80	72,000.00
TIMS	0.00	
Shpenzime për marrje apartamenti me qira	345,000.00	
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-1,665,100.80</b>	<b>75,917.33</b>

Nga analiza financiare rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme në vlerën 1,665,100.80 lekë për pagesën e shumës 28,000 USD në datën e nënshkrimit të kontratës.

90. Pas kalimit të barrës së provës<sup>30</sup> lidhur me rezultatin negativ të analizës financiare, subjekti pretendoi se vlera totale e paguar për blerjen e apartamentit është 28,000 USD, të paguara 20,000 USD në vitin 2000 dhe 8,000 USD me kredi bankare. Ai pretendoi gjithashtu rilogaritjen e të ardhurave nga paga të përfituara prej tij dhe bashkëshortes në vitet 1994, 1995 dhe 1998, si dhe përfshirjen në analizë financiare të huamarrjeve nga shtetasit H.B dhe S.V.

91. Në përfundim të hetimit, pasi vlerësoi provat e administruara, si dhe dëgjoi subjektin në seancë dëgjimore për këtë apartament, Komisioni vlerëson:

**a. Në lidhje me çmimin e blerjes së apartamentit**

92. Trupi gjykues, duke marrë në konsideratë: (i) që për vitin 2000 nuk ka të dhëna nga EKB-ja për çmimin e apartamenteve në tregun e lirë; (ii) të dhënat e kontratave të ngjashme, nga ku

<sup>29</sup> Bazuar në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit, në analizë financiare janë përfshirë: (i) pagesa në shumën 28,000 USD, në datën e nënshkrimit të kontratës; (ii) pagesa në shumën 8,000 USD, në datën e transferimit të saj në llogarinë e shoqërisë “S.M” sh.p.k.; (iii) të ardhurat e dokumentuara nga paga e subjektit dhe bashkëshortes së tij; (iv) huaja e marrë nga shtetasi K.B dhe shlyerja e kësaj huaje në vitet 2001 – 2007; (v) huaja e marrë nga shtetasi E.H dhe shlyerja e kësaj huaje në vitet 2004 – 2007; (vi) kredia bankare në vlerën 8,000 USD, e marrë në BIA Bank, disbursuar më 13.2.2001; (vii) shpenzimet jetike të përllogaritura në masën 30% deri në vitin 1999 dhe, në vijim, sipas shkresës ref. nr. \*\*\* prot., datë 29.1.2019, të ILDKPKI-së; (viii) shpenzime për marrjen me qira të ambientit të banimit, të deklaruara nga subjekti në pyetësorin standard; (ix) në analizë është konsideruar si kursim nga subjekti shuma 1,524,648.20 lekë (ndryshe nga sa ka deklaruar subjekti, në shumën 13,000 USD), e cila është rezultat i mundësisë kumulative për periudhën 1992 – 1999; (x) në analizë nuk është konsideruar huaja e marrë nga shtetasi H.B në vlerën 2,000 USD dhe huaja e marrë nga shtetasi S.V në vlerën 1,500 USD, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion të ardhurat e ligjshme të huadhënësve, të cilat kanë shërbyer si burim për dhënien e këtyre huave.

<sup>30</sup> Për më shumë, referojuni provave dhe shpjegimeve të paraqitura nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit.

rezulton se çmimi i blerjes nga subjekti është gati sa dyfishi i vlerës së tyre; (iii) vlerën e shitjes së apartamentit, e cila është më e lartë se kostoja e ndërtimit; (iv) që subjekti ka qenë konsistent në deklarin e vlerës së këtij apartamenti në të gjitha deklarinimet e tij, periodike apo atë *Vetting*; (v) që shoqëria ndërtuese ka konfirmuar faktin se pagesa është kryer në shumën 28,000 USD, si dhe nuk disponon dokumentacion për shkak të kalimit të afateve ligjore – krijon bindjen se çmimi i blerjes së këtij apartamenti ka qenë në shumën 28,000 USD<sup>31</sup>, sikundër është deklaruar nga subjekti.

**93.** Komisioni gjatë hetimit nuk ka arritur të evidentojë veprime të subjektit që kanë për qëllim fshehjen apo deklarinim e pasaktë të pasurisë së tij. Komisioni krijon bindjen e plotë se në asnjë rrethanë subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer dhe nuk ka tentuar të kryejë ndonjë deklarinim të rremë në lidhje me pagesën e çmimit të blerjes së apartamentit, gjithashtu, nuk ka fshehur dhe nuk ka tentuar të fshehtë burime financiare të paligjshme, që do të mund të përdreshin për blerjen e këtij apartamenti. Në këto kushte, në analizë financiare vlera e apartamentit do të konsiderohet e paguar në dy këste, përkatësisht në vlerën 20,000 USD në momentin e lidhjes së kontratës dhe në vlerën 8,000 USD, kur është marrë kredia bankare.

#### **b. Në lidhje me huat e marra**

**94.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura prej tij, vlerëson se subjekti ka deklaruar huamarrjet që në deklarinim e tij për herë të parë në vitin 2003, si dhe në deklaratën *Vetting*. Në përputhje me pikën 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, huadhënësit kanë konfirmuar huadhënien nëpërmjet deklaratave noteriale. Hartimi i kontratës së huas nuk është kusht *sine qua non* për të provuar marrëdhënien e huadhënies, nisur edhe nga fakti se me dy huadhënës ekziston lidhje gjaku, ndërsa dy të tjerë pranojnë marrëdhënien e ngushtë shoqërore.

**95.** Në bazë të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, subjekti ka detyrimin të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësve. Në këtë pikë, subjekti ka arritur të provojë me dokumentacion burimin e ligjshëm të vetëm tre prej huadhënësve, përkatësisht shtetasve K.B, E.H dhe S.V. Komisioni vlerëson të mos përfshijë si burim për blerjen e apartamentit huan e deklaruar nga shtetasi H.B.

**96.** Në këto kushte, Komisioni kreu sërish analizën financiare, paraqitur në tabelën si më poshtë:

**Tabela nr. 4**

	<b>Periudha 1992 – 2000</b>	<b>13.2.2001</b>
<b>Pasuria</b>	<b>4,124,600.00</b>	<b>0.00</b>
Apartament me sip. 93 m <sup>3</sup>	3,993,920.00	
Automjet tip “Opel Cadet”	130,680.00	
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	0.00	<i>0.00</i>

<sup>31</sup> Ky qëndrim i Komisionit bazohet dhe në rastet të njëjta në KPK konkretisht: (i) Vendim nr.332/2021, i cili është rekomanduar nga ONM dhe ankimuar nga Komisioneri Publik dhe në të dy këto akte nuk është bërë ankim në lidhje me përfshirjen si burim të kredisë në vlerën 30.000 euro, e cila ishte disbursuar pas lidhjes së kontratës së shitblerjes dhe palët deklaronin likuidimin në datën e blerjes, për shumë shih pikat 1.6.3-1.11 të këtij vendimi. (ii) Vendim nr.153/2019, i cili nuk është ankimuar. Shih trajtimin e bërë në lidhje me apartament me sipërfaqe 136 m2 dhe apartament me sipërfaqe 73 m2, faqja 6-14 e vendimit. (iii) Vendim nr.627/2023, i cili nuk rezulton të jetë ankimuar nga Komisioneri Publik ku fillimisht Komisioni nuk e ka përfshirë kredinë në rezultatet e hetimit si burim dhe më pas e ka konsideruar. Shih pikën 13.24 dhe pikat 13.49-13.53 të këtij vendimi. (iv) Vendim nr.394/2021, i cili nuk rezulton të jetë ankimuar nga Komisioneri Publik, ku fillimisht Komisioni nuk e ka përfshirë kredinë në rezultatet e hetimit si burim dhe më pas e ka konsideruar, shih pikën 1.10 dhe 1.12 të këtij vendimi. (v) Vendim nr.581, datë 1.11.2022, i cili nuk rezulton të jetë ankimuar nga Komisioneri Publik ku fillimisht Komisioni nuk e ka përfshirë kredinë në rezultatet e hetimit si burim dhe më pas e ka konsideruar. Shih faqe 5, paragraf 2 dhe faqe 6 dhe 7 të këtij vendimi.

<b>Detyrime</b>	<b>1,854,320.00</b>	<b>0.00</b>
Detyrim ndaj shoqërisë “S.M” sh.p.k.	3,993,920.00	
Shlyerje detyrimi shoqërisë “S.M” sh.p.k.	-2,852,800.00	-1,092,400.00
Kredi në BIA, 13.2.2001, shuma 8,000 USD	0.00	1,092,400.00
Hua S.V 1,500 USD	213,960.00	
Hua H.B 2,000 USD	0.00	
Hua K.B 2,000 USD	285,280.00	
Hua E.H 1,500 USD	213,960.00	
<b>Pasuria neto</b>	<b>2,270,280.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Të ardhura</b>	<b>3,827,829.09</b>	<b>147,917.33</b>
Të ardhura e subjektit nga paga	2,171,051.55	83,144.33
Të ardhura e bashkëshortes së subjektit nga paga	1,656,777.55	64,773.00
<b>Shpenzime</b>	<b>1,690,769.43</b>	<b>72,000.00</b>
Shpenzime jetike	1,345,769.43	72,000.00
TIMS	0.00	
Shpenzime për qira (prill 1998 – mars 2000)	345,000.00	
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-133,220.34</b>	<b>75,917.33</b>

**97.** Nga analiza financiare rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në vlerën -133,220.34 lekë për pagesën e kështit prej 20,000 USD, të çmimit të apartamentit në vitin 2000. Komisioni vlerëson se kjo pamjaftueshmëri nuk përbën shkak që deklarimi i subjektit të konsiderohet i pamjaftueshëm, në kuptim të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016.

**98.** Komisioni ka kryer edhe një analizë hipotetike, duke e konsideruar çmimin e blerjes së këtij apartamenti në shumën 36,000 USD. Nga analiza financiare rezulton se subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e këtij apartamenti në shumën 1,274,340.34 lekë. Në këto kushte, edhe sikur për një moment të merret si vlerë e apartamentit shuma 36,000 USD, mungesa e mjeteve financiare është e tillë që, bazuar në praktikën e Komisionit, por edhe të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në raste të ngjashme, nuk përbën shkak autonom për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

**99.** Në përfundim, duke marrë në konsideratë vlerën e ulët të mungesës së burimeve të ligjshme për këtë pasuri, kohën e krijimit të kësaj pasurie, duke iu referuar edhe paragrafit 96 të vendimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), S vs Albania, parë nën dritën e parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, Komisioni vlerëson se kjo shumë nuk klasifikohet si deklarim i pamjaftueshëm për të shërbyer si shkak autonom për shkarkimin e subjektit nga detyra.

**100. Automjet<sup>32</sup> tip “Mercedes-Benz” me targë AA \*\*\* OZ, blerë në Gjermani në vlerën 3,500 euro, në datën 3.10.2016, llogaritur shpenzime transporti e transportuesi. Vlera e asetit: 3,500 euro.**

**Burimi sipas deklaratës Vetting:** blerje me kredi marrë nga “Credins Bank”, në shumën 500,000 lekë, me nr. \*\*\*, datë 22.9.2016, bashkë me bashkëshorten V.B.

<sup>32</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) urdhër çlirimi, Zyra Doganore Q.B, datë 3.10.2016 (bashkëlidhur dokumentacioni i plotë i zhdoganimit të automjetit); (ii) kontratë kredie afatmesme nr. \*\*\*, datë 22.9.2016, nga “Credins Bank”.

### **Hetimi<sup>33</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**101.** Me kontratë shitblerjeje automjeti datë 1.10.2016, të hartuar në gjuhën gjermane, subjekti i rivlerësimit ka blerë nga shtetasja R.Sh automjetin tip “Mercedes-Benz” (vit prodhimi 2002), për çmimin 950 euro. Referuar deklaramit të subjektit në DPV/2016 dhe në deklaratën *Vetting*, ky çmim nuk përfshin kostot e transportit dhe të transportuesit.

**102.** Referuar Deklaratës Doganore Import 4, datë 3.10.2016, ky automjet është zhdoganuar kundrejt vlerës 73,262 lekë, me eksportues R.Sh dhe importues Ylli Bashaj.

**103.** Subjekti e ka deklaruar blerjen e këtij automjeti në DPV/2016 me të njëjtin përshkrim si në deklaratën *Vetting*.

**104.** Si burim për blerjen e këtij automjeti subjekti ka deklaruar kredinë bankare të marrë pranë “Credins Bank”. Nga analizimi i dokumentacionit bankar lidhur me këtë kredi, rezulton se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në cilësinë e kredimarrëses dhe subjekti në cilësinë e dorëzanësit kanë nënshkruar në “Credins Bank” kontratën e kredisë afatmesme nr. \*\*\*, datë 22.9.2016, për vlerën 500,000 lekë, me afat 24 muaj, me qëllim financimi konsumator.

**105.** Nga nxjerrja e llogarisë së bashkëshortes së subjektit në “Credins Bank”, rezulton se në datën 22.9.2016 në llogarinë e bashkëshortes së subjektit është disbursuar kredia në vlerën 500,000 lekë. Këtë shumë bashkëshortja e subjektit e ka tërhequr ditën e disbursimit.

**106.** Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni ka rezultuar se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e këtij automjeti.

**107.** Në përfundim të hetimit, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri të subjektit. Subjekti ka kryer deklaramit të saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie.

**108. Automjet<sup>34</sup> tip “Mercedes-Benz” me targë TR \*\*\* D, blerë nga shtetasi Sh.L në shumën 250,000 lekë, me kontratën nr. \*\*\* rep., \*\*\* kol., datë 17.9.2004.** Automjet i shitur për skrap për vlerën 35,000 lekë, nxjerrë jashtë përdorimi me dokumentin e shitjes datë 30.9.2016.

**Burimi sipas deklaratës *Vetting*: të ardhura të siguruara nga paga e të shlyera me këste.**

### **Hetimi<sup>35</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**109.** Me kontratë shitblerjeje automjeti nr. \*\*\*, datë 17.9.2004, subjekti i rivlerësimit ka blerë nga shtetasi Sh.L automjetin tip “Mercedes-Benz” (vit prodhimi 1991), për çmimin 250,000 lekë. Çmimi i shitjes deklarohet i likuiduar jashtë zyrës noteriale.

**110.** Subjekti e ka deklaruar blerjen e këtij automjeti në DPV/2004 me të njëjtin përshkrim si në deklaratën *Vetting*.

**111.** Sipas vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 7.10.2016, të DPSHTRR Drejtoria Rajonale Tiranë, rezulton se ky automjet është hequr nga qarkullimi përfundimisht në datën 7.10.2016, për arsye

<sup>33</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.9.2020, drejtuar DPSHTRR-së; kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 28.9.2020, e DPSHTRR-së; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.9.2020, drejtuar “Credins Bank”; kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 30.12.2020, e “Credins Bank”.

<sup>34</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) kontratë shitblerjeje automjeti nr. \*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë 17.9.2004; (ii) vërtetim nga pika e skrapit “M”, datë 30.9.2016, për dorëzimin e automjetit tip “Mercedes-Benz \*\*\*” nga Ylli Bashaj, leje qarkullimi automjeti me targë TR \*\*\* \*D, në emër të Ylli Bashaj; (iii) vërtetim nr. TRF \*\*\*, për heqjen e përhershme të mjetit nga qarkullimi, lëshuar nga DPSHTRR-ja; (iv) faturë pagese e taksave vjetore për vitin 2016, si dhe faturë tatimore për pagesën e bërë për çregjistrimin e përhershëm të mjetit.

<sup>35</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 18.9.2020, drejtuar DPSHTRR-së; kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 30.9.2020, e DPSHTRR-së.

“jashtë përdorimi”. Heqja e përhershme nga qarkullimi është bërë sipas kërkesës së aplikantit Ylli Bashaj, i cili ka dorëzuar targën e automjetit dhe lejen e qarkullimit të tij.

**112.** Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* faturën tatimore datë 30.9.2016, në vlerën 35,000 lekë, për çregjistrimin e mjetit, dhe dorëzimin e tij në pikën e skrapit në V, Tiranë.

**113.** Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, ka rezultuar se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e këtij automjeti.

**114.** Në përfundim të hetimit, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri të subjektit. Subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie.

**115. Dhurim në favor të vëllait K.B i ¼ të apartamentit me sipërfaqe 62.5 m<sup>2</sup>, të ndodhur në lagjen “I. B”, rruga “S. Z”, Vlorë. Vlera e asetit: 1,250,000 lekë. Pjesa takuese: 25%.**

**Burimi sipas deklaratës *Vetting*: kontratë dhurimi nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 28.2.2013.**

### **Hetimi<sup>36</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**116.** Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar dhurimin e pjesës takuese të pasurisë, që ai ka disponuar në bashkëpronësi me familjarët e tij N, K dhe F.B. Nga dokumentacioni i administruar në lidhje me këtë pasuri, ka rezultuar:

**117.** Me kontratë privatizimi datë 22.7.1993 dhe kontratë shitjeje datë 12.8.1993, lidhur me NK Banesa, nëna e subjektit të rivlerësimit ka blerë apartament banimi me sip. 62.5 m<sup>2</sup>, të ndodhur në lagjen “\*\* Nëntori”, Vlorë, për çmimin 15,744 lekë.

**118.** Bazuar në gjendjen familjare të familjes së subjektit, në datën 1.12.1992, pasuria është regjistruar në bashkëpronësi të pandarë të tyre<sup>37</sup>.

**119.** Me kontratë dhurimi nr. \*\*, datë 28.2.2013, subjekti dhe nëna e tij i kanë dhuruar pjesët e tyre takuese në këtë apartament bashkëpronarëve K e F.B.

**120.** Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri në DPV/2003, me përshkrimin “*Apartament në qytetin e Vlorës, 3+1, me burim privatizimin e banesave me ligjin e vitit 1992 nga ana e shtetit, ku zotëroj ¼ pjesë takuese*”. Në vijim, në DPV/2013 ai ka deklaruar dhurimin në favor të vëllait K.B të ¼ të apartamentit, përmes kontratës së dhurimit nr. \*\*, datë 28.2.2013.

**121.** Në përfundim të hetimit, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri dhe dhurimin e kryer nga subjekti në favor të vëllait të tij.

### **DETYRIME FINANCIARE**

#### **122. Kredimarrje e subjektit në “Union Bank”, në datën 10.12.2015**

**123.** Me kontratë kredie bankare datë 10.12.2015, lidhur me “Union Bank”, subjekti i rivlerësimit ka përfituar një kredi në vlerën 58,660 lekë, me qëllim “Blerje laptop Toshiba dhe telefon LG”. Kjo kredi është lëvruar për një afat 12-mujor.

**124.** Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* fletën e garancisë të lëshuar nga kompania shitëse e produkteve elektronike, për të cilët është financuar me kredi bankare.

**125.** Në përfundim, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë detyrim financiar të subjektit.

---

<sup>36</sup> Shkresë nr. \*\*prot., datë 17.9.2020, drejtuar ILDKPKI-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\* prot., datë 21.9.2020, e ILDKPKI-së; dokumentacion i shkarkuar nga sistemi elektronik multifunksional i ASHK-së.

<sup>37</sup> Në momentin e nënshkrimit të kontratës, familja e subjektit përbëhej nga subjekti, nëna e tij, vëllai dhe bashkëshortja e vëllait.

**126. Kredimarrje në “Credins Bank” në shumën 500,000 lekë, për blerjen e një automjeti, me kontratën nr. \*\*\*, datë 22.9.20116**

127. Kjo kredi bankare është trajtuar në cilësinë e burimit të krijimit të pasurisë automjet tip “Mercedes-Benz” me targë AA \*\*\* OZ dhe nuk janë konstatuar dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë detyrim financiar të subjektit.

## **PASURITË E BASHKËSHORTES SË SUBJEKTIT**

**128. Overdraft në vlerën 100,000 lekë, i bashkëshortes së subjektit V.B**

**Hetimi<sup>38</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

129. Në datën 5.1.2010, bashkëshortja e subjektit ka çelur në “Credins Bank” një llogari page.

Nga nxjerrja e llogarisë rezulton se në datën 24.5.2011 nga kjo llogari është tërhequr *overdraft* në shumën 100,000 lekë. Në vijim, kjo llogari është furnizuar përmes kreditimit të pagës së bashkëshortes së subjektit.

130. Në përfundim të hetimit, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari.

**131. Para të depozituara në depozitën “Plus” në “Credins Bank” në vlerën 100,329 lekë, burimi i të cilave janë të ardhurat personale të pagës mujore të bashkëshortes V.B**

132. Nga nxjerrja e llogarisë së bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit në “Credins Bank”, rezulton se në datën 4.2.2011 ajo ka çelur llogari depozitë, të cilën e ka furnizuar periodikisht me fondet e llogarisë së pagës. Në datën 23.1.2017, gjendja e kësaj depozite rezulton me vlerë 100,329 lekë.

133. Në përfundim të hetimit, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë depozitë.

**134. Kartë krediti e papërdorur, me vlerë 50,000 lekë**

135. Nga nxjerrja e llogarisë së bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit në “Credins Bank”, rezulton se në datën 2.4.2013 znj. V.B ka çelur llogarinë nr. \*\*\*, e cila shërben si llogari e lidhur me kartën “V.P.I”, përdorur për periudhën 2.4.2013 – 2.10.2014.

Në datën 6.4.2016, znj. V.B ka çelur llogarinë nr. \*\*\*, e cila shërben gjithashtu si llogari e lidhur me kartën “V.P.I”, përdorur për periudhën 4.6.2016 – 17.10.2016.

136. Komisioni nuk ka konstatuar ndonjë parregullsi në lidhje me këtë llogari.

## **Konstatime të tjera**

**137. Automjet tip “Opel” me targë TR \*\*\* E, blerë në vitin 1995, shitur në datën 30.1.2007, për çmimin 1,000 euro**

**Hetimi<sup>39</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

138. DPSHTRR-ja ka vënë në dispozicion dokumentacionin e automjetit me targë TR \*\*\* E, i cili aktualisht figuron me statusin “çregjistrim i përhershëm”. Në dosjen e mjetit nuk gjendet kontrata e blerjes së tij nga subjekti Ylli Bashaj, por evidentohet leja e qarkullimit provizore, datë 28.10.1998.

---

<sup>38</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.9.2020, drejtuar “Credins Bank”; kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 30.12.2020 e “Credins Bank”.

<sup>39</sup> Shkresë nr.\*\*\* prot., datë 17.9.2020, drejtuar DPSHTRR-së; kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 28.9.2020, e DPSHTRR-së; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 4.10.2022, drejtuar DPSHTRR-së; kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 13.10.2022, e DPSHTRR-së.

**139.** Me kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 30.1.2007, subjekti i rivlerësimit e ka shitur këtë automjet në favor të blerëses I.P, për çmimin 1,000 euro, vlerë e cila deklarohet e likuiduar jashtë zyrës noteriale.

**140.** Subjekti e ka deklaruar këtë automjet në DPV/2003, me përshkrimin “Autoveturë Opel Cadet blerë nga shtetasi A.B për çmimin 2,000 marka gjermane, me të ardhura nga kursimet personale, regjistruar në vitin 1995”.

**141.** Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit paraqitjen e kopjes së kontratës së shitjes së këtij automjeti. Në përgjigje të pyetësorit datë 31.10.2022, subjekti ka vënë në dispozicion përgjigjen nr. \*\*\* prot., datë 9.11.2022, të DPSHTRR-së, në përmbajtje të së cilës ky institucion informon se: *“Mjeti me targë VL \*\*\* A ka qenë i regjistruar në pronësi të Ylli Bashaj në datën 21.11.1995. Dosja e mjetit nuk gjendet në arkiva, ndaj nuk mund t’ju vëmë në dispozicion kopje të kontratës së blerjes së automjetit apo ndonjë dokument tjetër”*.

Bazuar në informacionin e mësipërm, Komisioni ka përfshirë në analizën financiare të subjektit blerjen e automjetit në datën 21.11.1995, në vlerën 2,000 marka gjermane.

**142.** Në përfundim të hetimit, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri të subjektit.

**143. Shkollimi i vajzës së subjektit S.B në Itali, për periudhën tetor 2013 – prill 2014 (1 semestër shkollor)**

**144.** Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar: *“Që nga momenti i marrjes së detyrës, kam realizuar shpenzime më të larta se 2,500 euro që prej vitit 2013. Në këtë vit ka filluar studimet në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i Padovas, vajza ime S.B, e cila ka qëndruar aty nga muaji tetor 2013 deri në muajin prill 2014, periudhë pas së cilës ajo është kthyer në Shqipëri për të vazhduar studimet e mëtejshme në universitetin “Z.K.M”, Tiranë. Gjatë periudhës së qëndrimit të saj në Itali është paguar shuma prej 800 euro, si pagesë vjetore studimi. Vajza ka përdorur për banim një apartament të marrë me qira në Padova “V.S.P”, nr. \*\*\*. Për të është paguar qira mujore prej 340 euro, e cila për periudhën 7-mujore të qëndrimit të saj kap shumën prej 2,380 euro, pa përfshirë shpenzimet për ushqim, konsum të ujit, energjisë elektrike, e ato që quhen shpenzime kondominiale, që arrijnë në shumën 250 euro/muaj. Për këtë periudhë shpenzimet në total kapin shumën rreth 1,750 euro... Shpenzimet e realizuara për arsimimin e fëmijëve janë paguar nga depozitat e kursimeve të krijuara ndër vite dhe e kanë pasur burimin nga pagat e mia dhe të bashkëshortes”*.

**145.** Subjekti i ka bashkëlidhur përgjigjes së tij dokumentacionin lidhur me të drejtën e studimit të përfituar nga vajza e tij S.B në shtetin italian.

**146.** Në përgjigje të pyetësorit datë 31.10.2022, subjekti ka depozituar:

- i. kontratë qiraje datë 1.10.2013, lidhur mes qiradhënësit L.P dhe qiramarrësit S.B në Padova Itali, me afat 4 + 4 muaj dhe qira mujore 340 euro;
- ii. urdhërpagesë bankare datë 10.11.2013, urdhëruar nga S.B në bankën “Casa di Risparmio del Veneto”, në vlerën 1,100.50 euro, në favor të qiradhënëses L. P;
- iii. urdhërpagesë bankare datë 12.12.2013, urdhëruar nga S.B në bankën “Casa di Risparmio del Veneto”, në vlerën 420.50 euro, në favor të qiradhënëses L. P;
- iv. urdhërpagesë bankare datë 14.1.2014, urdhëruar nga S.B në bankën “Casa di Risparmio del Veneto”, në vlerën 420.50 euro, në favor të qiradhënëses L. P;
- v. urdhërpagesë bankare datë 12.2.2014, urdhëruar nga S.B në bankën “Casa di Risparmio del Veneto”, në vlerën 420.50 euro, në favor të qiradhënëses L. P;
- vi. vërtetim i Universitetit të Padovas, datë 7.10.2013, ku citohet se S.B është regjistruar për të ndjekur studimet pranë këtij universiteti për vitin akademik 2013 – 2014, në degën “Mjekësi dhe kirurgji”;

- vii. mandatpagesë në bankën “Casa di Risparmio del Veneto”, datë 2.10.2013, përmes së cilës S.B ka paguar në favor të Universitetit të Padovas vlerën 563.38 euro;
- viii. deklaratë konsullore e Ambasadës Italiane në Tiranë, në të cilën citohet miratimi i vizës së studimit tipi “D”, në favor të S.B. Në përmbajtje të këtij dokumenti citohet edhe vendqëndrimi i siguruar nga shtetasi L.K;
- ix. formular regjistrimi datë 2.10.2013, i S.B, për vitin akademik 2013 – 2014, në Universitetin e Padovas.

**147.** Në rubrikën “Shpenzime të deklarueshme” në DPV/2013, subjekti ka deklaruar “Shpenzime për studimet e vajzës në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Padovas, në vlerën 1,400,000 lekë”.

**148.** Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ILDKPKI-ja<sup>40</sup>, në lidhje me pagesat e kryera për shkollimin e vajzës S.B, evidentohen mandatpagesat si vijon:

- mandat tërheqje i vlerës 1,762 euro nga S.B, në datën 27.11.2013, në llogarinë e saj në “Intesa Sanpaolo Bank”;
- mandat tërheqje i vlerës 20,000 lekë nga S.B, në datën 1.10.2013, në llogarinë e saj në “Credins Bank”;
- mandat tërheqje i vlerës 600,000 lekë nga V.B, në datën 7.5.2013, në llogarinë e saj në “Raiffeisen Bank”;
- mandat tërheqje i vlerës 300,000 lekë nga V.B, në datën 22.10.2013, në llogarinë e saj në “Credins Bank”;
- mandat tërheqje *cash* i vlerës 403,821.86 lekë nga V.B, në datën 12.4.2013, në llogarinë e saj të depozitës në “Credins Bank” dhe mbyllje e kësaj depozite.

**149.** Komisioni i ka kërkuar subjektit informacion lidhur me llogaritë e çelura nga vajza e tij S.B në shtetin italian. Në përgjigje të pyetësorit datë 31.10.2022, subjekti ka deklaruar: *“Nuk mund të jap përgjigje nëse vajza ime ka çelur llogari bankare në Padova, Itali, por di të sqaroj se pagesat e mia për shpenzimet e kryera nga vajza gjatë periudhës që ajo ka qenë në Itali për studime e për jetese i janë dhënë posaçërisht prej meje në formën e pagesës cash. Nëse ajo ka hapur llogari bankare, kjo gjë është bërë vetëm që ajo të realizojë ndërmjetësimin e bankës, për të kryer pagesat e nevojshme në institucionet përkatëse.”*

**150.** Në vijim, pavarësisht kërkesës së Komisionit për të depozituar dokumentacion bankar, si dhe vënies në dukje të faktit që mosdorëzimi i dokumentacionit do të konsiderohet si mungesë bashkëpunimi, subjekti sërish ka refuzuar të depozitojë nxjerrjet e llogarive të vajzës së tij në Itali për periudhën e rivlerësimit dhe në vijim. Bashkëlidhur përgjigjes së tij, subjekti ka paraqitur:

- Dokument nga “Intesa Sanpaolo Bank” Itali, për pajisjen e shtetases S.B me kartën bankare. Ky dokument nuk përmban emërtim, datë dhe të dhëna mbi llogarinë bankare të S.B pranë kësaj banke.
- Fotografim nga aparati celular lidhur me njoftimet e mbërritura në rrugë elektronike për kalimin e pagës mujore. Dokumenti i paraqitur nuk përmban të dhëna të mjaftueshme për të evidentuar llogarinë bankare të S.B dhe lëvizjet e kryera në këtë llogari.

**151.** Siç rezultoi nga pohimet e subjektit të rivlerësimit, vajza e tij S.B ka çelur llogari bankare në shtetin italian. Pavarësisht kërkesave të përsëritura të Komisionit për të vënë në dispozicion nxjerrjen e llogarisë bankare të vajzës së tij, subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion që pasqyron lëvizjet dhe transaksionet në këtë llogari, duke e vendosur Komisionin në pamundësi për verifikimin dhe analizimin e llogarive bankare të personit të lidhur S.B, si dhe në pamundësi për të bërë një analizë të plotë financiare të periudhës së rivlerësimit për subjektin. Për pasojë,

<sup>40</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.9.2020, drejtuar ILDKPKI-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 21.9.2020, e ILDKPKI-së.



Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit, përmes mosveprimeve të tij, ka reflektuar mungesë bashkëpunimi, në kuptim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

**152.** Në lidhje me këtë konstatim, në parashtrimet e tij<sup>41</sup>, subjekti pretendoi se *të gjitha pagesat për shpenzimet e kryera nga vajza e tij gjatë periudhës që ajo ka qenë në Itali, shpenzime që kanë mbuluar studimet dhe jetesën e saj, i janë dhënë posaçërisht prej tij në formën e pagesës cash... Depozita e vajzës së tij në “Intesa Sanpaolo Bank” ka shërbyer si garanci për marrjen e vizës nga ana e saj për të ndjekur studimet në shtetin italian. Në këtë llogari janë kryer veprimet si vijon: në datën 27.11.2013 tërhiqet shuma 1,762.55 euro dhe në datën 8.1.2014 shuma 3,999 euro. Kjo është pikërisht periudha që përkon me qëndrimin e vajzës së tij në Itali, e konstatimet... Janë këto shuma parash që i janë vënë në dispozicion vajzës për të vazhduar studimet në Itali, për një periudhë relativisht të shkurtër, të cilat i ka pasqyruar edhe më herët. Nëpërmjet këtyre të dhënave, duket qartë se kush ka qenë burimi i financimit për periudhën e qëndrimit të vajzës në Itali dhe vlera e tyre.*

Subjekti i ka bashkëlidhur shpjegimeve të tij nxjerrjen e llogarisë bankare të vajzës S.B në “Intesa Sanpaolo” Itali, për vitet 2021 – 2022.

**153.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, duke konsideruar faktin se shkollimi i vajzës së tij në shtetin italian ka zgjatur vetëm për 1 semestër shkollor dhe shpenzimet e kryera për këtë shkollim janë deklaruar saktësisht nga subjekti, si dhe janë provuar me dokumentacion provues, i vlerëson bindëse shpjegimet e tij në lidhje me këtë konstatim. Komisioni verifikoi edhe nxjerrjet e llogarisë bankare të vajzës së subjektit në “Intesa Sanpaolo Bank” për periudhën 2021 – 2022 dhe konkludon se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me lëvizjet bankare të vajzës së tij.

#### **154. Shkollimi i djalit të subjektit E.B në Shqipëri, për periudhën 2015 – 2.7.2020**

**155.** Në DPV/2015, në rubrikën “Shpenzimet e deklarueshme”, subjekti ka deklaruar: *“5,400 euro për arsimimin e vajzës S.B dhe të djalit E.B në universitetin “Z.K.M”, Tiranë, në vlerat 4,500 euro vajza dhe 900 euro djali”.*

**156.** Në DPV/2016, në rubrikën “Shpenzimet e deklarueshme”, subjekti ka deklaruar: *“Për shkollimin e dy fëmijëve S dhe E.B në universitetin “Z.K.M”, Tiranë, shpenzime vjetore 4,500 euro për vajzën dhe 1,500 euro për djalin. Në total 6,000 euro”.*

**157.** Në DPV/2017, në rubrikën “Shpenzimet e deklarueshme”, subjekti ka deklaruar: *“Për shkollimin e dy fëmijëve S dhe E.B në universitetin “Z.K.M” Tiranë, shpenzime vjetore 5,000 euro në total, 4,500 euro për vajzën dhe 500 euro për djalin”.*

**158.** Në përgjigje të pyetësorit standard në lidhje me shkollimin e djalit të tij E.B, subjekti ka sqaruar se: *“...Në vitin 2015, në universitetin “Z.K.M”, ka filluar studimet me pagesë në Fakultetin Ekonomik, dega Economia Aziendale edhe djali im E.B e për secilin vit pagesat e tij janë në total 4,548.5 euro”.*

**159.** Për të vërtetuar shpenzimet e deklaruar për shkollimin e djalit E.B, në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka depozituar vërtetimet e universitetit “Z.K.M”, si vijon:

- i. vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 2.7.2020, për periudhën 1.1.2015 – 31.12.2015, tarifa e paguar për E.B është në vlerën 900 euro;
- ii. vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 2.7.2020, për periudhën 1.1.2016 – 31.12.2016, tarifa e paguar për E.B është në vlerën 1,575 euro;

---

<sup>41</sup> Për më shumë, referojuni provave dhe shpjegimeve të paraqitura nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit.

iii. vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 2.7.2020, për periudhën 1.1.2017 – 31.12.2017, tarifa e paguar për E.B është në vlerën 1,014.5 euro.

**160.** Nga dokumentacioni i administruar rezulton se djali i subjektit ka ndjekur studimet në universitetin “Z.K.M” nga viti 2015 deri në datën 2.7.2020. Bazuar në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit shpenzimet e shkollimit të djalit E.B janë përfshirë në analizën financiare të subjektit, në përputhje me vlerat e dokumentuara nga vërtetimet e lëshuara nga universiteti “Z.K.M”.

Në përgjigje të pyetësorit datë 31.10.2022, subjekti ka sqaruar: “...djali im E.B është me status civil beqar dhe jeton bashkë me mua. Aktualisht vazhdon studimet pasuniversitare në Itali”.

**161.** Në përfundim, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me shpenzimet e deklaruara nga subjekti për shkollimin e djalit të tij.

## **162. Në lidhje me llogaritë bankare të subjektit, bashkëshortes dhe vajzës së tij**

### **Hetimi<sup>42</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**163.** Nga të dhënat e administruar nga “Intesa Sanpaolo Bank”, rezulton se vajza e subjektit ka çelur në datën 8.5.2013 llogarinë bankare nr. \*\*\* në euro, në shumën 5,750 euro, nën përshkrimin “Cash depozit S.Ylli.Bashaj, kursime të babait”.

**164.** Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, rezulton se subjekti dhe personat e lidhur me të kanë pasur mundësi për krijimin e gjendjes *cash* prej 5,750 euro, që shërben për çeljen e depozitës nga vajza e tij në “Intesa Sanpaolo Bank”.

**165.** Nga të dhënat e administruar nga “Union Bank”, rezulton se subjekti ka pasur një llogari bankare në lekë, e cila është përdorur si llogari mbështetëse për “Kredi afatshkurtër me normë interesi fiks dhe 0% komision”. Gjendja e llogarisë në datën 31.12.2016 ka qenë në vlerën 684.7 lekë.

**166.** Komisioni nuk ka konstatuar ndonjë parregullsi në lidhje me këtë llogari.

**167.** Nga të dhënat e administruar nga “Credins Bank”, rezulton se:

- a) Subjekti ka çelur llogarinë bankare rrjedhëse nr. \*\*\*, në lekë, e cila është përdorur si llogari page për periudhën 3.5.2012 e në vazhdim. Gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2016 është 466.09 lekë.
- b) Bashkëshortja e subjektit V.B, në moment e plotësimit të deklaratës *Vetting*, rezulton se ka pasur aktive llogaritë e mëposhtme:
  - i. Llogari bankare rrjedhëse nr. \*\*\*, në lekë, e cila është përdorur si llogari page për periudhën 5.1.2010 e në vazhdim. Gjendja e llogarisë në datën 31.12.2016 është 119,776 lekë.
  - ii. Llogari bankare depozitë nr. \*\*\*, në lekë, e çelur në datën 4.2.2011, e cila furnizohet periodikisht nga llogaria e pagës. Në datën 6.7.2012, nga kjo llogari bashkëshortja e subjektit ka transferuar shumën 400,000 lekë, në depozitë me afat maturimi 6-mujor. Gjendja e llogarisë në datën 31.12.2016 është 35,329 lekë.
  - iii. Llogari bankare depozitë nr. \*\*\*, në lekë, me afat 6-mujor, e çelur në datën 6.7.2012, në vlerë 400,000 lekë. Në datën 12.4.2013, bashkëshortja e subjektit mbyll depozitën, duke tërhequr *cash* shumën 400,000 lekë. Gjendja e llogarisë në datën 31.12.2016 është 0 (zero) lekë.

---

<sup>42</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 30.12.2020, e “Credins Bank”; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.9.2020, e “Intesa Sanpaolo Bank”; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.9.2020, e “Union Bank”; shkresë nr. OP-\*\*\* prot., datë 23.9.2020, e “ProCredit Bank”; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.10.2020, e “Raiffeisen Bank”.

- iv. Llogari bankare nr. \*\*\* "I.C", produkt bankar me parapagim, e çelur në datën 2.4.2013. Kjo llogari është përdorur nga bashkëshortja e subjektit kryesisht për blerje "bileta" nga kompanitë ajrore "A", "F" dhe "B". Gjendja e llogarisë në datën 31.12.2016 është 149 lekë.
  - v. Llogari bankare nr. \*\*\* "I.C", karta produkt bankar me parapagim, e çelur në datën 6.4.2016. Kjo llogari është përdorur nga bashkëshortja e subjektit kryesisht për blerje artikujsh të shportës. Gjendja e llogarisë në datën 31.12.2016 është 122 lekë.
  - vi. Llogari bankare nr. \*\*\* "V.C", e çelur në datën 5.7.2013. Kjo llogari është përdorur nga bashkëshortja e subjektit kryesisht për blerje artikujsh të shportës. Gjendja e llogarisë në datën 31.12.2016 është -49,178 lekë.
  - vii. Llogari bankare nr. \*\*\*, në lekë, e cila është përdorur si llogari mbështetëse për "Kredi standarde në lekë", në vlerën 500,000 lekë, e disbursuar në datën 21.9.2016. Detyrimi i mbetur në datën 31.12.2016 ka qenë 453,681 lekë.
- c) Vajza e subjektit S.B ka pasur llogari bankare "Llogari për fëmijë", nr. \*\*\*, në lekë, çelur në datën 26.3.2007, e cila ka shërbyer për kalimin e bursës akorduar nga Bashkia Tiranë për periudhën 26.3.2007 – 31.1.2011. Gjendja e llogarisë në datën 31.12.2016 është 0 (zero) lekë.

**168.** Nga të dhënat e administruar nga "ProCredit Bank", rezulton se subjekti i rivlerësimit ka çelur llogaritë bankare si vijon:

- i. Llogari bankare nr. \*\*\*, në lekë, e cila është përdorur si depozitë për periudhën 21.9.2006 – 21.9.2016. Gjendja në datën 31.12.2016 është 258,582.37 lekë.
- ii. Llogari bankare nr. \*\*\*, në lekë, e cila është përdorur si depozitë për periudhën 16.11.2006 – 16.5.2015. Gjendja në datën 31.12.2016 është 0 (zero) lekë.
- iii. Llogari bankare nr. \*\*\*, në lekë, e cila është përdorur si depozitë për periudhën 8.10.2007 – 8.10.2015. Gjendja në datën 31.12.2016 është 0 (zero) lekë.
- iv. Llogari bankare nr. \*\*\*, në lekë, e cila është përdorur si depozitë për periudhën 17.3.2008 – 18.3.2016. Gjendja në datën 31.12.2016 është 285,782.21 lekë.
- v. Llogari bankare nr. \*\*\*, në lekë, e cila është përdorur si llogari rrjedhëse për periudhën 21.9.2006 – 28.7.2017. Kjo gjendje është furnizuar me fonde nga depozitat e sipërcituara pas maturimit. Gjendja në datën 31.12.2016 është 490,000 lekë.

**169.** Nga analiza financiarë e kryer nga Komisioni, rezulton se subjekti dhe personat e lidhur me të kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e depozitave fillestare dhe, për rrjedhojë, edhe të depozitës prej 490,000 lekësh.

**170.** Nga të dhënat e administruar nga "Raiffeisen Bank", rezulton se:

- a) Subjekti ka çelur llogarinë bankare nr. \*\*\*-ALL-\*\*\*, në lekë, e cila është përdorur si llogari page për periudhën 31.3.2005 – 2.5.2012. Gjendja në datën 31.12.2016 është 0 (zero) lekë.
- b) Bashkëshortja e subjektit V.B rezulton se ka pasur aktive llogaritë bankare si vijon:
  - i. Llogari bankare nr. \*\*-ALL-\*\*\*, në lekë, e cila është përdorur si llogari page për periudhën 1.4.2005 – 1.1.2010. Gjendja në datën 31.12.2016 është 0 (zero) lekë.
  - ii. Llogari investimi në bono thesari/obligacione nr. \*\*-ALL-\*\*\*, sipas të cilit bashkëshortja e subjektit ka derdhur në datën 11.11.2005 shumën 320,000 lekë, që shërben për blerje bono thesari.
  - iii. Në datën 20.7.2006, bashkëshortja e subjektit ka derdhur në këtë llogari shumën 200,000 lekë dhe pas maturimit të bonove të thesarit në vlerën 320,000 lekë ka investuar sërish në bono shumën 509,772 leke. Pas maturimit periodik të këtyre fondeve dhe përfitimit të interesave, rezulton se në datën 2.5.2013 fondi në bono thesari është në shumën 600,000 lekë. Në datën 7.5.2013, bashkëshortja e subjektit tërheq nga llogaria, nën përshkrimin "V. B tërheqje", shumën 600,000 lekë.

**171.** Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, rezulton se subjekti dhe personat e lidhur me të kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e shumës 320,000 lekë në vitin 2005.

**172.** Në lidhje me llogaritë bankare të sipërcituara, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk i ka deklaruar ato në deklaratën *Vetting* e, për rrjedhojë, duket se deklarimi i subjektit është i pasaktë për sa i përket llogarive bankare të çelura në emër të tij dhe personave të lidhur me të. Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime bindëse në lidhje me këtë konstatim.

**173.** Në prapësimet e tij, subjekti ka shpjeguar se *llogaritë bankare kanë qenë të deklaruara në momentin fillestar me depozitimin e tyre në shumat përkatëse dhe ato kanë ndryshuar vetëm kur ka ndërhyrë për të bërë transaksione të ndryshme. Në kontratat për depozitat, të nënshkruara, ka pasur një klauzolë për përfitimin e përqindjes së interesave. Për këto të fundit, në kontratat e nënshkruara nga palët e përfshira në marrëdhënie thuhej se në përfundim të afatit, për përfitimin e interesave në favor të depozituesit, përqindja e interesit aplikohet dhe krijonte efekte në mënyrë automatike, pa ndërhyrjen e tij ose të pjesëtarëve të tjerë të familjes. Pra, në asnjë rast nuk kanë nënshkruar shtojca të kontratave. Kjo gjë ka bërë që të mos marrë dajeni për të ardhurat e shtuara në këto depozita, qoftë ai, qoftë pjesëtarët e tjerë të familjes, veprim ky që ka sjellë si pasojë edhe mungesën e pasqyrimit në deklaratat periodike të pasurisë të shtesave të siguruara nga interesat.*

**174.** Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit në lidhje me mungesën e deklarimit të llogarive bankare në deklaratën *Vetting*, nuk janë bindëse. Megjithatë, ndonëse subjekti nuk i është përmbajtur përcaktimit ligjor të pikës 11 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, fakti që nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar se llogaritë në fjalë kanë qenë me gjendje minimale, si dhe nuk është konstatuar problematikë lidhur me burimin e krijimit të tyre, Komisioni vlerëson se kemi të bëjmë me një pasaktësi, e cila nuk shoqërohet me mungesë burimesh të ligjshme, duke mos përbërë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit për subjektin e rivlerësimit.

**175.** Në përfundim të hetimit, Komisioni ka kryer analizën financiare<sup>43</sup> për subjektin e rivlerësimit, sipas së cilës ai ka qenë në pamundësi mjjetesh financiare vetëm për vitin 2000, vit që përkon me blerjen e apartamentit, në vlerën 1,665,100.80 lekë. Për këtë pamundësi financiare, subjektit iu kalua barra e provës.

**176.** Në lidhje me këtë pamundësi, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe qëndrimi i Komisionit është trajtuar gjerësisht në pasurinë apartament të subjektit, për rrjedhojë, për të mos rënë në përsëritje, pasi ka kryer analizën financiare, ka rezultuar se subjekti gjendet në pamundësi mjjetesh financiare vetëm për vitin 2000, në vlerën 133,220.34 lekë.

### **Konkluzion për vlerësimin e pasurisë**

**177.** Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht në deklaratën *Vetting* pasuritë e tij dhe të personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

**178.** Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë. Ai ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk është përprjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Ylli Bashaj, nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

---

<sup>43</sup> Referojuni rezultateve të hetimit dërguar subjektit.

**179.** Në lidhje me problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se pasaktësitë në deklarim dhe balanca negative e fondeve në vlerën 133,220.34 lekë (ose 1,274,340.3 lekë, nëse në analizën financiare do të konsiderohej si çmim i blerjes së apartamentit vlera 36,000 USD), e përqendruar në një vit të vetëm për blerjen e një pasurie të vetme, si dhe duke marrë në konsideratë faktin se subjekti ka një karrierë më shumë se 30-vjeçare si prokuror, nuk është e mjaftueshme që të pasjellë aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi vlerësimi sigurisht që duhet të kryhet nëpërmjet një analize kritike, por ai duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

**180.** Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, vlera e bilancit negativ zë një peshë krahasimisht të vogël në raport me vlerën e blerjes së pasurive objekt kontrolli, si dhe nga analiza financiare e kryer për çdo vit subjekti rezulton me balanca pozitive të të ardhurave dhe shpenzimeve në një shumë totale prej 10,739,146 lekësh, për pasojë kjo vlerë negative nuk duhet të ndikojë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni çmon se për shkak të peshës specifike të vogël dhe mungesës së pasojave, nuk cenohet figura e prokurorit dhe as besimi i publikut te drejtësia.

**181.** Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Ylli Bashaj, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

**182.** Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Ylli Bashaj, me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

**183.** Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar në Komision raportin<sup>44</sup> mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Ylli Bashaj, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaramen për kontrollin e figurës; si dhe (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të kimit të organizuar.

**184.** Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

**185.** Komisioni kreu një hetim<sup>45</sup> të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetit të subjektit të rivlerësimit Ylli Bashaj. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e saj në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

## **Konkluzion për vlerësimin e kontrollit të figurës**

<sup>44</sup> Raporti nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*, datë 6.1.2021, të KDZH-së.

<sup>45</sup> Shihni dosjen me informacion të klasifikuar të subjektit të rivlerësimit.

**186.** Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Ylli Bashaj, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

### **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

**187.** Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

- raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLP-ja;
- kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- denoncimet e paraqitura pranë Komisionit.

#### **Raporti i hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë**

**188.** Ky raport është përgatitur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**189.** Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; (ii) pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme.

**190.** Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; (ç) aftësia personale dhe angazhimi profesional.

**191.** Nga verifikimi i tri dokumenteve ligjore të depozituara nga subjekti, nuk u konstatuan problematika.

**192.** Nga analizimi i 5 dosjeve të përzgjedhura me short, subjektit iu kërkuan shpjegime për dosjen nr. 3, procedimi penal nr. \*\*\*/2015, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me datë regjistrimi 28.5.2015, për veprën penale “falsifikimi i letërnjoftimeve, pasaportave ose i vizave”, parashikuar nga nenet 189/1 e 22 të Kodit Penal. Dokumenti ligjor “Vendim për pushimin e procedimit penal”, datë 14.7.2015.

**193.** Punonjësit e shoqërisë së prodhimit të dokumentacionit të identifikimit “A.S.G” kanë konstatuar se një shtetas kishte aplikuar dy herë për pasaportë biometrike, me gjeneralitete të ndryshme. Ka rezultuar se në të dyja rastet gjurmët identifikuese të aplikuesit ishin të njëjta. Zyra e gjendjes civile të Bashkisë Kamëz, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.6.2015, ka konfirmuar se shtetasi G. D. ishte banor i Njësisë Nr. \*\* të Tiranës. Njësia Bashkiake Nr. \*\*, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.6.2015, ka konfirmuar se të dhënat e zyrës së gjendjes civile të Bashkisë Kamëz ishin të dubluara dhe janë bllokuar, ndërsa shtetasi G. D. është vendosur në Njësinë Nr. \*\*, Tiranë.

**194.** Nga të dhënat e administruara, rezultonte se aplikimet në të dyja rastet ishin kryer nga i njëjti person, shtetasi G. D. Në lidhje me këtë fakt, ky shtetas ka pranuar se ka aplikuar në të dyja zyrat e gjendjes civile. Në analizë të rrethanave dhe provave të administruara në fashikull, subjekti ka konkluduar se shtetasi G. D., duke aplikuar dhe pajisur me pasaportë, me gjeneralitete të falsifikuara, kishte konsumuar plotësisht elementet e veprës penale “falsifikimi i letërnjoftimeve, pasaportave ose i vizave”, parashikuar nga neni 189/1 i Kodit Penal. Subjekti ka argumentuar se shtetasi G. D. nuk mund të merrej i pandehur, për shkak të parashkrimit të

ndjekjes penale. Duke analizuar faktin se nga momenti i kryerjes së veprës penale, që rezultonte aplikimi në datën 11.2.2010 në zyrën e gjendjes civile të Bashkisë Kamëz, kishte kaluar një periudhë kohore mbi 5 vjet dhe vepra penale e parashikuar nga neni 189/1 i Kodit Penal parashikonte dënim deri në 4 vjet burgim, subjekti ka konkluduar se ndjekja penale ishte parashkruar dhe se shtetasi G. D. nuk mund të merrej në përgjegjësi penale. Bazuar në nenin 66, shkronja “c” e Kodit Penal, si dhe nenin 328/1, shkronja “d” e Kodit të Procedurës Penale, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e çështjes penale në datën 14.7.2015.

**195.** Komisioni ka analizuar fashikullin penal të këtij procedimi, duke marrë në konsideratë faktin se vepra penale e falsifikimit<sup>46</sup> shfaqet në dy forma: atë të prodhimit dhe atë të përdorimit. Në rastin e subjektit nuk gjendet e analizuar në vendim nëse ky shtetas i kishte përdorur dokumentet e falsifikuara, në mënyrë të tillë që të ishim në kushtet e parashkrimit të veprës penale. Në lidhje me këtë procedim, Komisioni konstaton se:

- i. Subjekti nuk ka sekuestruar dokumentet e pretenduara të falsifikuara dhe që kanë qenë objekt hetimi. Në urdhrin për delegimin e kompetencave, datë 29.5.2015, evidentohet urdhërimi i subjektit të rivlerësimit për administrimin e kopjes së pasaportës të shtetasit G.L (pasaportë me të dhëna të falsifikuara), por në përmbajtje të fashikullit penal nuk rezulton të jetë administruar ky dokument i falsifikuar.
- ii. Subjekti nuk ka hetuar në lidhje me përdorimin e këtij dokumenti të falsifikuar nga ana e personit në hetim, si dhe të pasojave që mund të kenë ardhur nga ky përdorim.
- iii. Subjekti nuk ka disponuar në lidhje me asgjësimin e dokumenteve të falsifikuara.

Në përfundim, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore me qëllim arritjen në konkluzionin se jemi përpara parashkrimit të ndjekjes penale. Subjektit iu kërkua të japë shpjegime bindëse në lidhje me këtë konstatim.

**196.** Në prapësimet e tij, subjekti<sup>47</sup> shpjegoi: *“Në datën 28.5.2015, mbi bazë të materialeve të dërguara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, për veprën penale “falsifikimi i letërnjoftimeve, pasaportave ose i vizave”, parashikuar nga nenet 189/1 e 22 të Kodit Penal. Që në momentin e regjistrimit të çështjes penale duket se vepra nuk është kryer, por ka mbetur në fazën e tentativës. Në vazhdim dhe nga të dhënat e grumbulluara gjatë hetimeve paraprake ka rezultuar se nëpërmjet shkresës nr. \*\*-k/\*\*\*, datë 22.4.2015, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka informuar Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë se kompania e prodhimit të dokumenteve të identifikimit “A.S.G” ka konstatuar se një shtetas shqiptar ka aplikuar dy herë për pasaportë biometrike, me gjeneralitete të ndryshme. Në rastin e parë, shtetasi me nr. personal E\*\*\*J, me gjeneralitetet G.L, i biri i M dhe i F, i datëlindjes 15.6.1942, lindur në Dajt dhe banues në Kamëz, Tiranë, ka aplikuar për dokumentin e sipërpërmendur, në datën 11.2.2010, pranë zyrës së gjendjes civile të qytetit të Kamzës. Ndërsa, në rastin e dytë, shtetasi me nr. personal F\*\*\*H, me gjeneralitetet G.D, i biri i M dhe i F, i datëlindjes 1.12.1957, lindur në P dhe banues në Tiranë, ka aplikuar për dokumentin e sipërpërmendur, në datën 1.4.2015, pranë zyrës së gjendjes civile të Njësisë Bashkiake Nr. \*\* të qytetit të Tiranës... Të dhënat tregojnë se aplikanti i vetëm dhe i vërtetë ka qenë shtetasi G.D për të dyja rastet e aplikimit për pasaporta biometrike, në dy zyrat e gjendjes civile, por, ai, në të dyja rastet e aplikimit të tij nuk është pajisur me dokument të tillë. Për rrjedhojë, jo vetëm që nuk është sekuestruar ndonjë dokument i llojit pasaportë, sepse nuk ka ekzistuar një i tillë, por edhe*

<sup>46</sup> Falsifikimi ose përdorimi i letërnjoftimeve, i pasaportave apo i vizave të falsifikuara dënohet me burgim nga 6 muaj deri në 4 vjet. Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, apo ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga 6 muaj deri në 5 vjet. Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë letërnjoftimin, pasaportën apo vizën, dënohet me burgim nga 3 deri në 7 vjet.

<sup>47</sup> Për më shumë, referojuni provave dhe shpjegimeve të paraqitura nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit.

*nuk ka pasur arsye për të marrë vendim për sekuestrimin e tij, pavarësisht se thuhet se një veprim i tillë është pasqyruar edhe në aktin e delegimit... Për ta qartësuar edhe më tej këtë situatë, bashkëlidh edhe raportin e personit G.D, nxjerrë nga sistemi elektronik TIMS, në të cilin pasqyrohet fakti se personi në fjalë nuk ka pasur një dokument të tillë e, për rrjedhojë, nuk ka asnjë hyrje-dalje nga territori i Republikës së Shqipërisë, fakt ky që tregon se shtetasi G.D nuk mund të jetë subjekt i veprës penale të falsifikimit të pasaportave, në formën e përdorimit të saj”.*

**197.** Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës: (i) vendimin për pushimin e çështjes; (ii) të dhënat e sistemit TIMS.

**198.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato kanë lidhje me themelin e çështjes, por nga ana e tij nuk janë dhënë shpjegime shteruese për kryerjen e të gjitha veprimeve hetimore dhe me verifikimin e faktit nëse ishte përdorur apo jo dokumenti i pretenduar si i falsifikuar. Të dhënat e sistemit TIMS të depozituara nga subjekti në cilësinë e provës pas dërgimit të rezultateve të hetimit nuk gjenden të administruara në fashikullin penal, provë e cila do të shërbente për të provuar që dokumenti i falsifikuar nuk ishte përdorur, për rrjedhojë subjekti në këtë rast ka shfaqur mangësi në drejtim të aftësive profesionale, në kuptim të nenit 73/2 të ligjit nr. 96/2016.

## **TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLD-së**

**199.** Nga verifikimi në arkivin e Drejtorisë Ekonomike dhe Burimeve Njerëzore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, konstatohet se nuk rezultojnë masa disiplinore ndaj subjektit Ylli Bashaj.

**200.** Mbi bazën e kërkesës së Komisionit, dërguar Prokurorisë së Përgjithshme dhe të gjitha prokurorive të rretheve gjyqësore, është kërkuar informacion lidhur me kallëzimet penale të regjistruara në emër të subjektit të rivlerësimit. Nga informacioni i administruar kanë rezultuar disa kallëzime penale dhe Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit për çështjen, si vijon:

**201.** Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me shkresën nr. \*\*\*prot., datë 28.7.2020, ka konfirmuar se ka regjistruar kallëzimin penal nr. \*\*\*/2018, mbi bazën e kallëzimit të shtetasit M.H. Ka rezultuar që shtetasi M.H kishte depozituar kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ndaj shtetasit L.C, elektrikist i OSHEE-së. Kallëzuesi ka pretenduar se prokurori i çështjes Ylli Bashaj nuk ka hetuar faktet e kallëzuar prej tij, por ka marrë vendim për mosfillimin e procedimit penal në datën 13.6.2018. Për këtë arsye, shtetasi M.H ka kërkuar ndjekje penale ndaj prokurorit.

**202.** Prokurori i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, pasi ka administruar aktet shkresore, ka konkluduar që vendimmarrja e prokurorit Ylli Bashaj nuk rezultonte të ishte e ndikuar nga interesa të kundërligjshme, shkaqe të dobëta etj., si dhe ishte marrë në përmbushje me kërkesat e ligjit, bazuar në provat e marra dhe bindjen e brendshme të krijuar mbi to. Prokurori ka sqaruar se vendimi i mosfillimit nuk mund të hetohej nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe se ishte rruga gjyqësore që duhej të ndiqej ndaj vendimit të prokurorit. Prokurori i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur mosfillimin e procedimit penal mbi bazën e kallëzimit të shtetasit M.H, në datën 20.11.2018.

**203.** Komisioni ka administruar<sup>48</sup> kopjen e procedimit penal nr. \*\*\*/2018, të hetuar nga subjekti i rivlerësimit, nga i cili ka rezultuar se:

**204.** Shtetasi M.H është pronar i një banese private në Tiranë. Në datën 1.7.2018, në verandën e tij, ai është përballur me një person, i cili ishte prezantuar si punonjës i OSHEE-së dhe quhej

---

<sup>48</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 13.3.2023, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.3.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.



L.C dhe ndodhej aty për të parë matësin e energjisë. Pas kërkesës së kallëzuesit, ky shtetas është larguar, por kallëzuesi i konsideron veprimet e tij në kundërshtim me ligjin dhe e ndjen veten të përndjekur dhe, për këtë shkak, në datën 4.7.2018, ka bërë kallëzim penal për veprat penale “dhunim banese”, parashikuar nga neni 112 i Kodit Penal dhe “përndjekje”, parashikuar nga neni 121 i Kodit Penal.

**205.** Subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se rrethanat e pasqyruara në këtë kallëzim duket se nuk plotësojnë asnjë nga elementet e veprave penale të pretenduara apo të ndonjë vepre tjetër penale. Ai sqaron se shtetasi L.C ka shkuar në banesën e kallëzuesit në ushtrim të detyrës së tij; ai ka qëndruar jashtë ambienteve të banesës së pronarit dhe është larguar menjëherë pas kërkesës së tij. Subjekti argumenton se edhe nëse do të ishte konsumuar vepra penale “dhunim i banesës”, ajo bën pjesë në ato kategori veprash që përfshihen në kriteret e parashikuara nga neni 59 i Kodit të Procedurës Penale, i cili bën fjalë për viktimën akuzuese. Sipas këtij neni i dëmtuari akuzues ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën. Subjekti konkludon se çështja mund të bëhet objekt i gjykimit të drejtpërdrejtë nga ana e gjykatës, sipas kërkesës së paraqitur para saj nga viktimja akuzuese M.H. Në mbështetje të neneve 59 e 290, pika 1, shkronja “e”, si dhe të nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale, ai ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

**206.** Nga analizimi i fashikullit penal, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer asnjë veprim hetimor verifikues, pasi nuk është marrë në pyetje kallëzuesi, nuk është verifikuar nëse i kallëzuarit ishte realisht i punësuar pranë OSHEE-së, si dhe nuk është verifikuar se sa herë ka shkuar në banesën e shtetasit M.H personi i kallëzuar.

**207.** Për rrjedhojë, Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore, si dhe vendimi i mosfillimit nuk është i argumentuar, për sa kohë nuk janë kryer këto veprime, duke i kërkuar shpjegime subjektit.

**208.** Subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, ka sqaruar<sup>49</sup>: *“Në lidhje me konstatimet e Komisionit për rastin në fjalë, mund të shpjegoj e sqaroj se në mbështetje të nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale, në të cilin thuhet se, kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e tij, është vlerësuar se në gjendjen që ndodheshin aktet e kallëzimit ekzistonin rrethana për mosfillimin e procedimit penal. Kryerja e veprimeve të tjera procedurale do të thoshte fillim i procedimit penal. Nuk ekziston në ligj termi “verifikim” në rastin e vendimmarrjes për mosfillimin e procedimit penal. Verifikimet njësohen me fillimin e ndjekjes penale e hetimin e çështjes në tërësi dhe janë objekt i një procesi, që njihet si proces i ndjekjes penale. Me vendimin nr. \*\*\* akti, të datës 16.11.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur shfuqizimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal, për kallëzimin penal të shtetasit M.H, të datës 4.7.2018, me nr. \*\*\*, dhe vazhdimin e hetimeve. Bazuar në këtë vendim, ka filluar edhe procesi i ndjekjes penale, është kryer regjistrimi i procedimit penal dhe është urdhëruar kryerja e veprimeve hetimore në përputhje me detyrat e caktuara nga gjykata, ku përfshihen edhe ato që pretendohet në relacion se nuk janë kryer nëpërmjet procesit të “verifikimit”, siç janë pyetja e kallëzuesit, verifikimet për shtetasin L.C, punësimin e tij etj. Në përfundim të hetimeve, të cilat nuk kanë ndryshuar qëndrimin e arsyetimit e prokurorit, që në momentin e vlerësimit të kallëzimit, me kërkesën e datës 20.2.2019, me të cilën është kërkuar pushimi i çështjes penale, fashikulli është dërguar për shqyrtim në gjykatë dhe me vendimin nr. \*\*\* akti, të datës 21.5.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pushimin e çështjes penale nr. \*\*/2019. Vendimi i mësipërm është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. \*, datë 13.1.2020”.*

---

<sup>49</sup> Për më shumë, referojuni provave dhe shpjegimeve të paraqitura nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit.

**209.** Subjekti ka depozituar në cilësinë e provës fashikullin penal të këtij procedimi, si dhe vendimin nr. \*\*\*, datë 21.5.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga analizimi i fashikullit penal konstatohet se subjekti ka vendosur në datën 4.1.2019 regjistrimin e procedimit penal, si dhe në po të njëjtën datë ka nxjerrë urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore.

**210.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, konstaton se nga ana e tij, pas vendimit të mosfillimit dhe shfuqizimit nga gjykata, është vendosur regjistrimi i procedimit penal, duke u kryer edhe veprimet e nevojshme hetimore. Në përfundim të hetimit, subjekti ka paraqitur kërkesën për pushimin e procedimit penal, kërkesë e cila është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit. Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit janë bindëse dhe duhet të merren në konsideratë. Ai ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, të cilat janë konfirmuar të plota edhe nga ana e gjykatave.

**211.** Nga aktet e procedimit penal rezultoi se vendimi i mosfillimit është ankimuar në gjykatë nga kallëzuesi M.H. Komisioni ka administruar<sup>50</sup> kopje të fashikullit gjyqësor të kësaj çështjeje, nga ku ka rezultuar:

**212.** Me kërkesat datë 27.9.2018 dhe 26.10.2018, gjyqtari i seancës paraprake i ka kërkuar prokurorisë informacion lidhur me faktin nëse është marrë ose jo në pyetje kallëzuesi M.H. Nga aktet e administruara nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të jetë përgjigjur në lidhje me këtë kërkesë të gjykatës. Nga procesverbalet e administruara në dosje gjyqësore rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk është paraqitur në asnjë nga seancat gjyqësore të zhvilluara, duke mos i dhënë përgjigje kërkesës së gjyqtarit të seancës paraprake.

**213.** Për sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk është paraqitur në asnjë nga seancat gjyqësore për të përfaqësuar në gjykim organin e akuzës, si dhe nuk ka informuar gjykatën në lidhje me kërkesën e saj për marrjen në pyetje të kallëzuesit. Për rrjedhojë, duket se ai nuk ka përfaqësuar në mënyrë efektive organin e prokurorisë në gjykatë. Subjektit i janë kërkuar shpjegime lidhur me këtë konstatimin.

**214.** Në shpjegimet e tij, subjekti ka sqaruar<sup>51</sup>: *“Aktualisht nuk është detyrim pjesëmarrja e prokurorit në seancën gjyqësore, me objekt “Kundërshtimi i vendimit të mosfillimit të procedimit penal mbi ankimin e kallëzuesit”. Konstatimi për mospjesëmarrje të prokurorit në tri seanca bën fjalë pikërisht për seancat e zhvilluara me këtë objekt gjykimi. Për të vërtetuar këto që thashë më sipër, referoj nenin 291/3 të Kodit të Procedurës Penale, aplikuar për kohën, sepse aktualisht ka ndryshuar, ku ka qenë parashikuar se, në rastet e gjykimeve të tilla, ankimi shqyrtohet në seancë gjyqësore, por kur palët nuk paraqiten, pa shkaqe të arsyeshme, gjykata vendos mbi aktet e paraqitura. Për vendimmarrjen për kundërshtimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal, gjykata është vënë në lëvizje me ankimin e kallëzuesit M.H e, në fund, me vendimin nr. \*\*\* akti, të datës 16.11.2018, është vendosur shfuqizimi i vendimit të mosfillimit për kallëzimin penal nr. \*\*\*/2018. Duke qenë se bëhet fjalë për mungesën e pjesëmarrjes së prokurorit në seancat gjyqësore, me objekt “Kundërshtimin e vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal”, bëj me dije se edhe aktualisht raste të tilla zgjidhen në dhomën e këshillimit nga gjyqtari i vetëm e një vlerësim i tillë bëhet mbi gjendjen e akteve. Ndryshimet janë pasqyruar në ligjin nr. 41/2021, datë 23.3.2021, e konkretisht ato janë përfshirë në pikën 3, ku thuhet se: “...ankimi shqyrtohet nga gjyqtari që gjykon kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake në dhomë këshillimi...”, etj.”*

<sup>50</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 1.3.2023, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 9.3.2023, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>51</sup> Për më shumë, referojuni provave dhe shpjegimeve të paraqitura nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit.

**215.** Pasi analizoi shpjegimet e subjektit, Komisioni vlerëson se ai duhet t'i kishte kushtuar rëndësinë e duhur pjesëmarrjes në gjykatë, për të mbrojtur një vendim i cili ishte i tij. Pavarësisht këtij konstatimi, për sa kohë dispozitat ligjore nuk ngarkojnë me përgjegjësi magjistratin për mospjesëmarrjen në gjykim në një procedim të tillë, këto veprime të subjektit nuk mund të përbëjnë shkak për t'u klasifikuar si mangësi profesionale.

**216.** Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.12.2020, ka konfirmuar se rezultojnë 4 praktika mbi bazën e ankesave të shtetasve ndaj prokurorit Ylli Bashaj. Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit vetëm për njërin prej këtyre ankesave, si vijon:

**217.** Rezultojnë praktika nr. \*\*\*/2020, mbi bazën e ankesës së shtetasës K.Sh, e cila është ankuar për hetimet e kryera nga subjekti Ylli Bashaj, për procedimin penal nr. \*\*\*/2018. Ankuesja pretendon për njëanshmëri të prokurorit në hetimet e kryera, në lidhje me kryerjen e ekspertimeve autoteknike në lidhje me aksidentin e shkaktuar ndaj bashkëshortit të saj. Pas shqyrtimit të akteve, Prokuroria e Përgjithshme ka dërguar për zgjidhje në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si organ procedues kompetent, trajtimin e ankesës së shtetasës K.Sh, duke e arkivuar praktikën.

**218.** Komisioni ka administruar kopjen e procedimit penal nr. \*\*\*/2018, nga shqyrtimi i të cilit rezultoi se në datën 10.9.2018, automjeti tip "Volkswagen", që drejtohej nga personi nën hetim A.Ç, është përplasur me shtetasin P.Sh, i cili ka qenë duke lëvizur në aksin rrugor Vorë-Tiranë, duke tentuar të kapërcente rrugën nga njëra anë në tjetrën. Si rezultat i përplasjes shtetasi P.Sh ka pësuar dëmtime të rrezikshme për jetën dhe është transportuar për në spital. Në lidhje me këtë ngjarje është regjistruar procedimi penal në ngarkim të shtetasit A.Ç, i akuzuar për veprën penale "shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor".

**219.** Subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar kryerjen e një sërë veprimesh hetimore, ndër të cilat edhe kryerjen e aktit të ekspertimit autoteknik, nga konkluzionet e të cilit nuk u konstatuan shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor nga personi nën hetim, i cili në momentin e ngjarjes qarkullonte me një shpejtësi prej 33.6 km/orë. Po në konkluzionet e këtij akti trajtohen dhe përcaktohen edhe shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor të kryera nga ana e këmbësorit dhe viktimës P.Sh. Me arsyetimin se mungon lidhja shkakësore ndërmjet veprimeve të kryera prej drejtuesit të mjetit dhe pasojës së ardhur, subjekti i ka drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkesën për pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit A.Ç.

**220.** Me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.2.2019, Gjykata ka vendosur të kthejë aktet pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke urdhëruar këtë të fundit të kryejë një akt të ri ekspertimi teknik, pasi akti i administruar gjatë hetimeve rezultoi me paqartësi të cilat e bëjnë atë të pabesueshëm dhe të papërdorshëm. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, e cila në vendimin e saj ka pasqyruar edhe kërkesat e gjykatës për të eliminuar paqartësitë e aktit, duke caktuar detyrat për subjektin e rivlerësimit, të cilat përfshijnë edhe kryerjen e një akti të ri ekspertimi.

**221.** Në zbatim të vendimeve gjyqësore, subjekti i rivlerësimit caktoi grupin e ekspertëve për përsëritjen e aktit të ekspertimit autoteknik. Në konkluzionet e këtij akti përcaktohet sërish shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor e kryer nga ana e këmbësorit/viktimës, por sipas këtij akti mjeti i shtetasit A.Ç rezultoi të ketë pasur një shpejtësi rreth 48,13 km/orë, në një segment ku shpejtësia maksimale e lejuar është 40 km/orë. Por, referuar llogaritjeve, ka rezultuar se drejtuesi i mjetit nuk do të kishte pasur mundësi teknike të shmangte goditjen, edhe nëse ai do të qarkullonte me shpejtësi 40 km/orë. Me arsyetimin se mungon lidhja shkakësore ndërmjet veprimeve të kryera prej drejtuesit të mjetit dhe pasojës së ardhur, në datën 25.11.2019, subjekti i ka drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkesën për pushimin e çështjes penale.

**222.** Në lidhje me këtë vendim pushimi, Komisioni konstaton se nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk janë zbatuar detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit, për rrjedhojë duket se ky vendim nuk është i argumentuar.

**223.** Me vendimin nr. \* akti, datë 11.3.2020, Gjykata ka vendosur të kthejë aktet pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke urdhëruar këtë të fundit të formulojë akuzë ndaj të hetuarit A.Ç, për kryerjen e veprës penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”. Subjekti i rivlerësimit, në formulimin e kërkesës për gjykim shprehet se pavarësisht qëndrimit të tij, urdhërimet e vendimeve të gjykatës krijojnë detyrimin për të ngritur akuzën ndaj personit nën hetim.

**224.** Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit në kërkesën për gjykim nuk ka mbrojtur interesat e organit të akuzës, por ka vijuar me qëndrimin e tij se çështja duhej të pushohej. Nëpërmjet këtij qëndrimi, subjekti ka shfaqur mendim në lidhje me objektin e procedimit, duke qenë në kushtet e konfliktit të interesit, në kuptim të nenit 17 të Kodit të Procedurës Penale dhe, për rrjedhojë, bazuar në nenin 26/1 të këtij Kodi kishte për detyrë të hiqte dorë. Siç rezulton nga përmbajtja e akteve të fashikullit penal, me vendimin nr. \*\*\*, datë 24.6.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit A.Ç. Ndaj këtij vendimi rezulton të ketë ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit, si përfaqësues i organit të akuzës, duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe deklarinimin e pafajshëm të të pandehurit.

**225.** Në përfundim të analizimit të dokumentacionit të administruar, Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk ka kryer veprime hetimore, si dhe nuk ka zbatuar detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit në vendimin nr. \*\*\*, datë 25.7.2019. Ai nuk ka argumentuar vendimin e pushimit të gjykimit, duke sjellë si pasojë formulimin e akuzës ndaj personit nën hetim nga ana e gjykatës. Në formulimin e kërkesës për gjykim, subjekti nuk ka mbrojtur interesat e organit të akuzës. Ai duket se ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, pasi ka shfaqur mendim në lidhje me objektin e procedimit, si dhe ka ankimuar një vendim të dhënë në favor të organit të akuzës. Në lidhje me këto konstatime, Komisioni i ka kaluar kërkuar shpjegime subjektit.

**226.** Në shpjegimet e tij, subjekti ka sqaruar<sup>52</sup>: *“Ngjarja e ndodhur në datën 10.9.2018 është e regjistruar nga kamerat e vendosura në objektet që ndodheshin në vendin ku ajo kishte ndodhur dhe pamjet janë regjistruar në formë elektronike, një disk, i cili është bërë pjesë e fashikullit të hetimit e më pas është bashkuar edhe me këtë fashikull si provë materiale, që do t’i shërbente gjykatës edhe për gjykimin e çështjes, një kopje e tij i është dhënë edhe shtetases K.Sh. Duke qenë se ngjarja e sipërpërmendur është regjistruar dhe qartësisht mund të shihet se çfarë ka ndodhur, them se të gjitha provat, që në një rast tjetër do të shërbenin për vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, janë të përfshira në diskut në fjalë... Shkak dhe pasojë e aksidentit të ndodhur ka qenë i aksidentuari, e konkretisht shtetasi P.Sh, i cili është përplasur me mjetin gjatë kapërcimit të rrugës e jo mjeti me të... Nëpërmjet të dhënave të pasqyruara në procesverbalin e datës 10.9.2018, mësohet se në orën 12:18:24 ka dalë nga lokali i sipërpërmendur një person i veshur me bluzë të bardhë dhe me pantallona të zeza. Në orën 12:18:44, një person që lëviz nga ana e lokalit për në krahun tjetër të rrugës automobilistike, që kalon edhe përpara lokalit, dhe në orën 12:18:46 personi që ka qenë duke kapërcyer rrugën përplasat me një mjet që lëvizte në korsinë e tij. Nga këqyrja vizive e pamjeve të regjistruara, duket qartë se personi, që është shtetasi P.Sh, ka shkuar me shpejtësi drejt mjetit, që ka qenë duke kaluar në rrugë, dhe është përplasur me të në pjesën anësore të tij... Në zbatim të detyrave të urdhëruara nga Gjykata e Apelit në vendimin nr. \*\*\*, datë 25.7.2019, rasti i është nënshtruar një ekspertimi të ri autoteknik, në të cilin janë ezauruar plotësisht detyrat e urdhëruara nga gjykata. Detyrat e caktuara nga Gjykata e Apelit, janë bërë pjesë e arsyetimit dhe konkluzioneve të aktit të ekspertimit autoteknik të datës 11.11.2019, të përpiluar ing.*

---

<sup>52</sup> Për më shumë, referojuni provave dhe shpjegimeve të paraqitura nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit.

mekanik A.J dhe ing. M.H... Në njërin prej akteve të ekspertimit autoteknike, pjesë e fashikullit, shpejtësia e autoveturës së përfshirë në ngjarje në momentin e aksidentit është përcaktuar në rendin 33.6 km/orë, ndërsa në aktin e dytë të ekspertimit autoteknik, kjo shpejtësi vlerësohet se ka qenë afërsisht e rendit maksimal 48.13 km/orë. Apriori, gjykata ka marrë të mirëqenë shpejtësinë më të lartë të mjetit të përfshirë në ngjarje, kur shifrat vënë në dyshim një gjë të tillë e për shkak të këtij dyshimi duhet të favorizohet i pandehuri, sipas kriterëve të parashikuara nga neni 4 i Kodit të Procedurës Penale... Në relacion vlerësohet se në aktin e ekspertimit nuk janë treguar në mënyrë ezauruese elementet e rrugës, pasi këto elemente janë me rëndësi për të saktësuar mekanizimin e ngjarjes dhe për të përcaktuar shkeljet eventuale. Në lidhje me këtë vlerësim, vetëm po citoj të dhënat e aktit të ekspertimit në fjalë, në të cilin thuhet se: “Referuar llogaritjeve matematiko-fizike, ka rezultuar se drejtuesi i automjetit me targë AA \*\*\* KS nuk ka pasur mundësi teknike të shmangte goditjen me këmbësorin, edhe nëse ai do të qarkullonte me shpejtësinë 40 km/orë... Në lidhje me shprehjen e përdorur se “në kërkesën për gjykim nuk janë mbrojtur interesat e akuzës, por ka vijuar me qëndrimin e tij”, shtroj pyetjen tjetër po në një tjetër rast, që në përfundim të shqyrtimit gjyqësor prokurori është i detyruar të tërheqë akuzën, që ai më herët e ka ngritur atë, a nëpërkëmben interesat e akuzës apo një qëndrim i tillë i shërben drejtësisë? E, në rastin konkret, edhe unë jam ndodhur në një situatë të tillë, por nuk kam qenë i ndikuar nga njëanshmëria. Në rast se do të isha i njëanshëm do të kisha kërkuar tërheqjen e akuzës dhe gjykata nuk kishte rrugë tjetër vetëm atë të dhënies së pafajësisë ose pushimin e çështjes. E kjo mënyrë veprimi është parashikuar në nenin 377 të Kodit të Procedurës Penale... Në asnjë rast nuk kam shfaqur mendim në lidhje me objektin e hetimit, sepse ai ishte i qartë, por në çdo rast i jam drejtuar gjykatës me kërkesat përkatëse, ku kam pasqyruar arsyet dhe bazën ligjore. Duke qenë se i vetmi organ i drejtësisë është gjykata dhe unë, si përfaqësues i akuzës, jam palë në proces, për kërkimet e mia kam ndjekur këtë rrugë dhe nuk kam pasur asnjë arsye për të hequr dorë nga hetimi e gjykimi i çështjes. Arsyetimet e mësipërme janë të mbështetur në ligj, them edhe se nuk ka asnjë shkak ligjor, të parashikuar në nenet 15, 16 e 17 të Kodit të Procedurës Penale, për të dhënë pëlqimin për të hequr dorë nga hetimi e gjykimi i çështjes penale nr. \*\*\*/2018, të zëvendësohesha apo të përjashtohesha nga gjykimi i saj...”

**227.** Pas analizimit të shpjegimeve të subjektit, Komisioni vlerëson se në kushtet kur gjykata vendosi deklarinimin fajtor të shtetasit A. Ç, subjekti nuk duhet ta ankimonte këtë vendim, por duhet të hiqte dorë nga përfaqësimi i organit të akuzës në lidhje me këtë procedim, për shkak të qëndrimit të tij në favor të të pandehurit. Por, për sa kohë nuk ka *indicie* për ndikim në vendimmarrje, si dhe kemi të bëjmë me një rast të vetëm në të cilin subjekti nuk ka vepruar në përputhje me funksionin e tij, Komisioni vlerëson se edhe sikur veprimet e tij në lidhje me këtë procedim të klasifikoheshin si mangësi profesionale, sipas përcaktimit të nenit 73/2 të ligjit nr. 96/2016, ato nuk do të ishin të një shkalle për të cilën duhej të aplikoheshin neni 61/4 i ligjit nr. 84/2016.

### **Denoncime**

**228.** Për subjektin e rivlerësimit janë administruar 11 denoncime të paraqitura pranë Komisionit. Për dy prej tyre, si në vijim, Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime.

### **Denoncim i shtetasit Xh.K<sup>53</sup>**

**229.** Shtetasi Xh.K ka bërë kallëzim penal ndaj mjekëve të QSUT-së, duke pretenduar kryerjen e veprës penale “mjekim i pakujdesshëm” ndaj nënës së tij, e cila ka ndërruar jetë rreth 12 orë pas kryerjes së një ndërhyrjeje kirurgjikale nga ana e personelit të QSUT-së. Denoncimin ai e ka bërë edhe në rrugë mediatike, në emisionin investigativ “Fiks Fare”. Denoncuesi pretendon se fillimisht hetimet për këtë çështje janë kryer nga dy prokurorë të tjerë, të cilët kanë vendosur

<sup>53</sup> Shkresë nr. \*\*\* datë 27.3.2019.

“pushimin e hetimeve”, por mbi bazën e ankimit të kallëzuesit këto vendime janë prishur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në kohën e dërgimit të ankesës hetimet janë kryer nga subjekti Ylli Bashaj, i cili në datën 26.2.2019 ka njoftuar kallëzuesin lidhur me “njoftimin për përfundimin e hetimeve”, duke e pyetur nëse ka prova shtesë e duke e vënë në dijeni me aktin e ekspertimit mjekoligjor nr. \*\*\* datë 12.2.2019.

**230.** Komisioni ka administruar<sup>54</sup> kopjen e procedimit penal nr. \*\*\*/2015, nga shqyrtimi i të cilit ka rezultuar:

**i.** Në datën 31.8.2015, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal për veprën penale “mjekim i pakujdesshëm”, parashikuar nga neni 96 i Kodit Penal. Procedimi është hetuar fillimisht nga dy subjekte të tjera rivlerësimi.

**ii.** Në datën 15.8.2016, Prokuroria ka vendosur pushimin e procedimit penal duke arsyetuar se, referuar aktit të ekspertimit mjekoligjor nr. \*\*\*, datë 27.6.2016 dhe në analizë të të gjitha provave të administruara gjatë hetimeve paraprake, nga ana e personelit mjekësor që është marrë me trajtimin e së ndjerës nuk janë konstatuar elemente të veprës penale “mjekim i pakujdesshëm”.

**iii.** Me vendimin nr. \*\*\* akti, datë 27.1.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor ka vendosur prishjen e vendimit të pushimit dhe vazhdimin e hetimeve, duke kërkuar konkretisht ribërjen e një akti ekspertimi mjekoligjor, ku të përcaktohet saktë shkaku i vdekjes, pyetja e kallëzuesit dhe ballafaqimi i tij me të kallëzuarit, si dhe administrimin e çdo prove tjetër të analizuar në harmoni me rezultatet e aktit të ekspertimit.

**iv.** Në datën 28.5.2018, me kërkesë të prokurorisë, është kryer akti i riekspertimit mjekoligjor për shtetasen A.K. Në konkluzionet e këtij akti citohet se në mungesë të autopsisë nuk mund të jepet një përgjigje shkencore se cila është diagnoza e sëmundjes e cila ka sjellë pasojën e vdekjes së saj. Bazuar në shënimet e bëra në kartelën klinike, rezulton se nga ana e stafit mjekësor është përcaktuar drejt diagnoza në përputhje me rezultatet e ekzaminimeve. Nuk rezulton të jenë konsumuar elemente të pakujdesisë apo neglizhencës mjekësore nga ana e personelit mjekësor.

**v.** Bazuar në konkluzionet e këtij akti riekspertimi, prokuroria i është drejtuar gjykatës me kërkesën për pushimin e procedimit të çështjes penale nr. \*\*\*/2015.

**vi.** Me vendimin nr. \*\*\* akti, datë 5.12.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur t'i kthehen aktet organit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të vazhduar hetimet sipas përcaktimeve në pjesën arsyetuese të këtij vendimi, ku citohet se akti i riekspertimit mjekoligjor nuk i ka dhënë përgjigje të gjitha pyetjeve të shtruara nga gjykata në vendimin datë 15.1.2016.

**vii.** Në vijim, me kërkesën datë 26.12.2018, prokurori i çështjes ka kërkuar heqjen dorë nga vazhdimi i hetimeve për këtë procedim, pasi nga ana e tij konsiderohen shteruese veprimet lidhur me këtë çështje.

**viii.** Çështja penale i ka kaluar në ndjekje subjektit Ylli Bashaj, i cili përmes vendimit datë 8.1.2019 ka vendosur caktimin e grupit të ekspertëve, duke i kërkuar përgjigjen e 7 pyetjeve teknike e shkencore në fushën e mjekësisë, toksikologjisë etj. Në konkluzionet e aktit citohet se sipas përshkrimeve në kartelën klinike rezulton se nga ana e stafit mjekësor, që është marrë me ndjekjen dhe trajtimin e shtetasës A. K, është përcaktuar drejt diagnoza në përputhje me rezultatet e ekzaminimeve. Nga ana e mjekëve kirurgë nuk ka pasur zvarritje në kohë për ndërhyrjen kirurgjikale, pasi sipas shënimeve të kartelës klinike rezulton se nga ana e

---

<sup>54</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 13.3.2023, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; shkresë kthim përgjigjeje nr.\*\*\* date 27.03.2023

familjarëve pëlqimi për ndërhyrjen kirurgjikale është dhënë në orën 22:40, datë 17.9.2015, ndërsa operacioni ka filluar në orën 23:15 të po kësaj date.

**ix.** Me vendimin datë 12.3.2019, subjekti i rivlerësimit, në analizë të të dhënave të pasqyruara në aktet e ekspertimit të kryer gjatë hetimit, ka konkluduar se vdekja e shtetasës A. K ka ndodhur për shkaqe natyrale dhe nuk ka qenë pasojë e ndonjë veprimi kriminal apo mjekimit të pakujdesshëm të ekipit mjekësor që e ka trajtuar. Për rrjedhojë, ai ka vendosur pushimin e hetimeve të çështjes penale nr. \*\*\*/2015.

**x.** Nga aktet e dosjes penale rezulton se ndaj këtij vendimi ka ushtruar ankim kallëzuesi Xh.K dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 17.6.2019, ka vendosur pushimin e procedimit penal.

**231.** Nga analizimi tërësor i akteve të procedimit penal, rezulton se pjesa më e madhe e veprimeve hetimore për këtë çështje është kryer nga të tjerë prokurorë dhe subjekti i rivlerësimit e ka marrë në ngarkim këtë hetim në vitin 2019, pas dorëheqjes së prokurorit të çështjes. Ai ka vijuar me caktimin e grupit të ekspertëve mjekoligjorë për përgatitjen e aktit të ekspertimit për plotësimin e mangësive në përgjigjet e akteve të mëparshme, në përputhje me orientimet e vendimit nr. \*\*\* akti, datë 5.12.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**232.** Në përmbajtje të vendimit për pushimin e çështjes penale, subjekti i rivlerësimit citon faktin se rasti ishte denoncuar edhe në media, por nuk analizon pamjet filmike të administruara në cilësinë e provës, në përmbajtje të dosjes penale.

**233.** Nga shqyrtimi i pamjeve fotografike<sup>55</sup> të administruara në dosjen penale, si dhe nga pamjet filmike të gjendura online në [https://www.\\*\\*\\*](https://www.***), duket se trajtimi mjekësor ndaj pacientes së ndjerë nuk është kryer në kohën e duhur, kryesisht për shkak të mungesës së mjekut reanimator. Kjo, pasi në pamjet filmike evidentohet vonesa në trajtimin e urgjencës mjekësore nga mjekët e repartit reanimator, të cilët, pavarësisht kërkesës së mjekut të shërbimit të urgjencës, nuk janë paraqitur në kohë për trajtimin e pacientes. Në materialin filmik, mjeku i urgjencës shprehet: *“Nuk ishte për në shtëpi... nuk po ma merrnin në pavijon, ndaj reagova ashtu... Unë po të them, për mua ishte për të qëndruar në spital. O zotëri, unë jam urgjencë këtu, po s’ma mori njëri më ngelet rasti këtu, ç’a të bej? Mora reanimator, mora tjetrën, tjetrën, kaq e kam fuqinë o shpirt, keni shumë të drejtë, por këtë fuqi kam”*. Më tej, ai dëgjohet të kryejë telefonatën *“Të lutem, kam një rast të rëndë, a kupton apo jo? Hajde këtu, hajde këtu urgjent”*. Në vijim, ai i shprehet familjarëve të pacientes *“Shihni situatën mor burrë, mua s’më vjen asnjë mjek. Po lajmëroj reanimatorët, s’më vjen njeri. Për shpirt të nënës nuk di ç’të bëj. E kupton, po ikën nëna juaj e s’më vjen njeri”*.

**234.** Në vendimin e pushimit të procedimit datë 12.3.2019, subjekti i rivlerësimit citon të dhënat e procesverbaleve të deklaramit nga mjekët e QSUT-së, të përfshirë në trajtimin e pacientes së ndjerë. Në deklaramet e tyre ata janë shprehur se nuk mund të përcaktojnë kohën që ka kaluar nga momenti që është kërkuar prezenca e mjekut reanimator deri në paraqitjen e tij. Vetë mjekja reanimatore, në lidhje me vonesën e pretenduar, shprehet se gjithçka është e pasqyruar në kartelën klinike të pacientes. Në vendimin e pushimit të procedimit, subjekti nuk ka analizuar thëniet e regjistruara në materialin filmik të emisionit investigativ.

**235.** Në përfundim të analizimit të dokumentacionit të administruar, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka analizuar përmbajtjen e materialit filmik të administruar nga emisioni investigativ, në të cilin evidentohen veprimet e mjekëve të QSUT-së, si dhe qëndrimet e tyre kundrejt familjarëve të pacientes. Gjithashtu, ai nuk ka analizuar në harmoni provat e administruara gjatë hetimit, duke mos evidentuar kundërshtitë mes deklarimeve të mjekëve të

---

<sup>55</sup> Këto fotografime rezultojnë të shkëputura nga pamjet filmike të regjistruara në emisionin investigativ e të sekuestruara me vendimin e datës 6.10.2015, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

QSUT-së dhe thëniet e regjistruara në materialin filmik. Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit në lidhje me këto konstatime.

**236.** Në shpjegimet e tij, subjekti ka sqaruar<sup>56</sup>: “Edhe pse gjatë hetimeve paraprake fillestare hetimi është drejtuar e kontrolluar nga një prokuror tjetër, madje edhe është marrë vendim prej tij në përfundim të këtij hetimi, konstatimet e sipërcituara janë adresuar ndaj prokurorit që ka vazhduar më tej hetimet, e ai jam unë. Më kryesoret janë qëndrimet që janë mbajtur nga specialistët e fushës, qëndrime që janë pasqyruar në arsyetimet e konkluzionet e akteve të ekspertimit mjekoligjorë nr. \*\*\*, të datës 28.5.2018, në të cilin thuhet ekzaktësisht se “...është konkluduar se, në mungesë të kryerjes së autopsisë, nuk mund të jepet një përgjigje shkencore se cila është diagnoza e sëmundjes që ka sjellë si pasojë vdekjen e shtetases A.K...” dhe të aktit të ekspertimit mjeko ligjor nr. \*\*\*, të datës 12.2.2019, në pikën 2 të të cilit arsyetohet se: “2. Referuar përshkrimeve në kartelën klinike, rezulton se nga ana e stafit mjekësor, që është marrë me ndjekjen dhe trajtimin e shtetases së mësipërme, është përcaktuar drejt diagnoza, në përputhje me rezultatet e ekzaminimeve. Nga ana e mjekëve kirurgë, nuk ka pasur zvarritje në kohë për ndërhyrjen kirurgjikale, pasi, sipas shënimeve të kartelës klinike, rezulton se nga ana e familjarëve, pëlqimi për ndërhyrjen kirurgjikale është dhënë në orën 22:40, të datës 17.9.2015, ndërsa operacioni ka filluar në orën 23:15 të po kësaj dite. Kjo gjë nuk ka ndikuar në pasojën e ardhur”. Ndërsa, në pikën 5 të tij thuhet se: “5. Referuar shqyrtimit të dokumentacionit mjekësor, rezulton se nga ana e personelit mjekësor, që ka trajtuar pacienten, në rastin konkret objekt hetimi, është ndjekur në mënyrë korrekte kryerja e disa hapave themelore, në përfundim të të cilave mjekët, nëpërmjet analizave interpretuese dhe të sintezës deduktive, sipas rregullit të Hipokratit, në bazë të të cilit duhet të përcaktojnë diagnozën dhe kuptohet edhe mjekimin përkatës”. Njëherazi, në këtë akt është përsëritur edhe se: “...Në mungesë të kryerjes së autopsisë dhe, për rrjedhojë, mungesës së diagnozës anatomopatologjike, nuk mund të japim një përgjigje shkencore...”.

Në përfundim, mund të them se kërkesa për pushimin e çështjes penale nr. \*\*\*/2015, është miratuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor me vendimin nr. \*\*\*, datë 17.6.2019, e vendimi në fjalë është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, me vendimin nr. \*\*, datë 1.12.2020, pas shqyrtimit të ankimit të shtetasit Xh.K. Rasti i sipërpërmendur është shqyrtuar edhe nga Inspektorati i Lartë i Drejtësisë, po mbi bazën e ankimit të shtetasit Xh.K, e me vendimin e datës 26.7.2022 është vendosur arkivimi i ankimit”.

**237.** Subjekti ka depozituar njoftim mbi vendimin e arkivimit të ankesës, pas verifikimit nr. \*\*\* prot., datë 26.7.2022, të ILD-së. Bashkëlidhur këtij njoftimi gjendet vendimi nr. \*\*\* prot., datë 26.7.2022, i ILD-së, mbi arkivimin e ankesës së paraqitur nga shtetasi Xh.K. Nga analizimi i këtij vendimi rezulton se për vendimin e pushimit të subjektit për procedimin penal objekt vlerësimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendim nr. \*\*\*, datë 17.6.2019, ka vendosur pranimin e kërkesës për pushimin e procedimit. Ky vendim është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit, me vendim nr. \*\*\* datë 1.12.2021.

**238.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pasi analizoi dokumentacionin e administruar lidhur me këtë denoncim, pavarësisht faktit që në vendimin e pushimit të çështjes nuk është analizuar përmbajtjen e materialit filmik në të cilin evidentohen veprimet e mjekëve të QSUT-së, si dhe qëndrimet e tyre kundrejt familjarëve të pacientes, Komisioni vlerëson se për sa kohë nga ana e gjykatave është vendosur pranimi i pushimit të procedimit penal, rezulton se hetimet kanë qenë të plota dhe, për rrjedhojë, nuk jemi në kushtet e mangësive profesionale nga ana e subjektit të rivlerësimit.

---

<sup>56</sup> Për më shumë, referojuni provave dhe shpjegimeve të paraqitura nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit.



## **Denoncim i shtetasit A.Sh<sup>57</sup>**

**239.** Denoncuesi ka depozituar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë kallëzimin penal ndaj trashëgimtarëve të pasurisë së nënës së tij, duke pretenduar se nga ana e tyre është kryer vepra penale “mashttrim”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal. Mbi bazën e kallëzimit të tij është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*/2016, i cili është hetuar nga subjekti i rivlerësimit Ylli Bashaj. Denoncuesi pretendon se subjekti nuk ka zbatuar vendimin gjyqësor nr. \*\*, datë 21.1.2019, të Gjykatës së Apelit Tiranë, përmes të cilit gjykata ka vendosur ndryshimin e vendimit të prokurorisë dhe vazhdimin e hetimeve për procedimin penal nr. \*\*\*/2016. Sipas tij, prokurori i çështjes nuk ka urdhëruar kryerjen e një akti ekspertimi, për të vërtetuar falsifikimin e dokumenteve të pretenduara prej tij. Denoncuesi i ka bashkëlidhur ankesës së tij kopje të njoftimit datë 5.7.2019, për përfundimin e hetimeve dhe pushimin e çështjes penale.

**240.** Komisioni ka administruar kopje të procedimit penal nr. \*\*/2016, nga i cili ka rezultuar se shtetasi A. Sh ka bërë disa kallëzime penale për veprën penale “falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Nga analiza e akteve procedurale të tyre rezulton se ai ka bërë kallëzim për të njëjtin fakt, si:

**i.** Kallëzimi nr. \*\*\*/2009, mbi bazën e të cilit është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*/2010, i cili është pushuar me vendimin përkatës, datë 9.11.2010. Kundër vendimit të pushimit të prokurorisë është bërë ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në të cilën është vendosur lënia në fuqi e vendimit të organit të prokurorisë. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. \*\*\* akti, datë 27.5.2011.

**ii.** Kallëzimi penal nr. \*\*\*, datë 10.12.2015, mbi bazën e të cilit është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*/2015.

**iii.** Kallëzimi penal nr. \*\*\*, datë 7.12.2015, mbi bazën e të cilit është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*/2017.

**iv.** Referimi penal nr. \*\*\*, datë 1.12.2015, pranë Policisë Gjyqësore, mbi bazën e të cilit është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*/2017.

**v.** Referimi penal nr. \*\*\*, datë 23.12.2016, pranë Komisarariatit nr. 4, mbi bazën e të cilit është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*/2017.

**241.** Duke qenë se rrethanat faktike mbi të cilat janë regjistruar procedimet e sipërcituara janë të njëjta me ato për të cilat është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*/2017, organi i prokurorisë ka bërë bashkimin e këtyre procedimeve në një të vetëm, në atë me nr. \*\*\*, viti 2016, i cili është hetuar nga një tjetër subjekt rivlerësimi, që ka vendosur pushimin e hetimeve, bazuar në parimin e ndalimit të gjykimit dy herë për të njëjtën veprë penale. Ky vendim është kundërshtuar nga kallëzuesi A.Sh. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*, datë 23.10.2018, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së tij, ndërsa Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. \*\*, datë 21.1.2019, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe prishjen e vendimit nr. \*\*\*, viti 2016, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vazhdimin e hetimeve, duke e konsideruar hetimin e kryer nga prokuroria si “jo të plotë”.

**242.** Pas kërkesës për “heqje dorë” të prokurorit të çështjes, ky procedim i ka kaluar në ndjekje subjektit Ylli Bashaj. Në aktet e procedimit penal nuk evidentohen veprime hetimore të kryera nga subjekti i rivlerësimit, në zbatim të vendimit nr. \*\*, datë 21.1.2019, të Gjykatës së Apelit Tiranë. Por, në datën 15.7.2019, ai ka përpiluar kërkesën “për pushimin e çështjes penale nr. \*\*/2016”, në përmbajtje të së cilës është cituar vendimi i Gjykatës së Apelit, por nuk citohen veprime hetimore të kryera nga ana e subjektit, në zbatim të këtij vendimi.

---

<sup>57</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 13.3.2023, drejtuar ONM-së.

**243.** Nga shqyrtimi i akteve të dosjes penale, Komisioni ka konstatuar se nga momenti që ka marrë në ngarkim këtë procedim penal, subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprime të mëtejshme hetimore, duke mos zbatuar detyrat e caktuara nga Gjykata e Apelit Tiranë në vendimin nr. \*\*, datë 21.1.2019. Subjektit i janë kërkuar shpjegime në lidhje me këtë konstatim.

**244.** Në shpjegimet e tij, subjekti ka sqaruar<sup>58</sup>: *“Me kërkesën e datës 15.7.2019, për pushimin e çështjes penale nr. \*\*\*/2016, fashikulli i është dërguar për shqyrtim Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me vendimin nr. S.P.\*\*\* të datës 24.12.2019 ka vendosur pranimin e kërkesës dhe pushimin e çështjes në fjalë. Në arsyetimin e vendimit të gjykatës, janë pasqyruar edhe argumentet përkatëse, që sqarojnë se pretendimet e shtetasit A.Sh nuk qëndrojnë.*

*Në arsyetimin e vendimit nr. S.P.\*\*\* të datës 24.12.2019 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, thuhet se Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. \*\*, datë 21.1.2019, ka vendosur vazhdimin e hetimeve, pasi organi i akuzës nuk ka kryer veprime për të hetuar integritetin e aktit, që konsiderohet i falsifikuar dhe, për pasojë, nuk është hetuar edhe për përdorimin e tij në vazhdimësi, në kushtet kur ai konsiderohet i falsifikuar. Siç shihet, edhe vendimi i Gjykatës së Apelit ka qenë pjesë e shqyrtimit të ankimit të shtetasit A.Sh në Gjykatën e Shkallës së Parë dhe në arsyetimin e gjatë që ka bërë kjo gjykatë, në përfundim ka çmuar se kërkesa e prokurorit për pushimin e procedimit penal është e bazuar në ligj e në prova dhe e ka pranuar atë. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 28.2.2020”.*

**245.** Subjekti ka depozituar vendimin nr. \*\*\*, datë 24.12.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga analizimi i këtij vendimi rezulton se gjykata ka marrë në shqyrtim edhe detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit<sup>59</sup>, duke listuar veprimet e kryera nga organi i prokurorisë për periudhën 15.4.2019 – 11.6.2019, duke konsideruar se këto veprime janë shteruese.

**246.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, si dhe duke u bazuar në vendimin e gjykatës, i cili nuk ka evidentuar parregullsi në veprimet hetimore të kryera prej subjektit për këtë procedim, vlerësoi të pranojë argumentet e dhëna prej tij në lidhje me këtë konstatim.

### **Konkluzion për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale**

**247.** Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga KLP-ja, denoncimeve të depozituara në Komision dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si më sipër, trupi gjykues vëren se nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit.

Në përfundim të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, trupit gjykues i rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale. Pavarësisht nga ky konstatim, si dhe nga sa u përshkrua më sipër, rezultoi se sjellja e subjektit të rivlerësimit në dy raste nuk ka qenë në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, lidhur me aftësinë profesionale të një prokurori. Si rrjedhojë e sa më sipër, Komisioni vlerëson se problematikat e konstatuara nuk ngrihen në nivelin e shkakut, që e bëjnë subjektin e rivlerësimit të papërshtatshëm, në kuptim të nenit 44, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, për të justifikuar vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 4 e këtij ligji.

Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

## **KONKLUZION PËRFUNDIMTAR**

<sup>58</sup> Për më shumë, referojuni provave dhe shpjegimeve të paraqitura nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit.

<sup>59</sup> Shihni paragrafët 2, 3 dhe 4 të faqes 11 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, dëgjoji subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se subjekti:

- i. arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- ii. arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- iii. ka një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, shkronja “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Ylli Bashaj, prokuror pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 14.6.2023.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Lulzim HAMITAJ**  
**Kryesues**

**Genta TAFA (BUNGO)**  
**Relatore**

**Valbona SANXHAKTARI**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Etmonda Hoxha*